



## RAPORT

SHQYRTIM I DINAMIKËS SË VARFËRISË SË AMVISËRIVE  
PËRBALLË INFLACIONIT: DËSHMI NGA NJË ANKETË

Korrik 2023

Mohim i përgjegjësisë: *Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve, bazuar në pikëpamjet e pjesëmarrësve në grupe të fokusit dhe të të intervistuarve dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e palëve të tjera*

## Tabela e përmbajtjes

<b>Tabela e përmbajtjes</b> .....	<b>3</b>
<b>Tabela e figurave/tabelave</b> .....	<b>4</b>
<b>Shkurtesat</b> .....	Error! Bookmark not defined.
<b>Përmbledhje ekzekutive</b> .....	<b>7</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>10</b>
<b>Pasqyra e literaturës</b> .....	<b>11</b>
Treguesit makroekonomikë të Kosovës .....	11
Shkaqet dhe pasojat e inflacionit .....	12
Ndikimi i inflacionit në mirëqenien ekonomike të ekonomive familjare: Çka thonë studimet .....	14
<b>Metodologjia</b> .....	<b>15</b>
<b>Rezultatet</b> .....	<b>17</b>
Informata demografike .....	17
Informata për punësimin e të anketuarve .....	19
Të hyrat dhe punësimi i të anketuarve dhe ekonomive familjare .....	21
Të hyrat e ekonomive familjare dhe punësimi.....	26
Shpenzimet e ekonomive familjare.....	31
Perceptimi i ekonomive familjare për mënyrën se si ndikon rritja e inflacionit në zgjedhjet dhe cilësinë e jetës së tyre .....	40
Modelet dhe ndryshimet e të hyrave dhe shpenzimeve .....	40
Kufiri i varfërisë dhe të dhënat e mostrës: Krahasimi i të hyrave në mes të viteve 2021 dhe 2023 .....	54
Borxhi .....	55
Ndihma Sociale .....	59
Remitancat.....	62
Ndikimi i inflacionit në mirëqenien sociale dhe mendore të të anketuarve .....	65
Veprimi institucional për adresimin e inflacionit.....	73
<b>Konkluzionet dhe rekomandimet</b> .....	<b>74</b>
<b>Referencat</b> .....	<b>77</b>

Tabela e figurave/tabelave

Figura 1. Përkatësia etnike e të anketuarve .....	18
Figura 2. Numri i anëtarëve që jetojnë në ekonominë familjare.....	19
Figura 3. Statusi i punësimit: 2022 deri 2023 .....	21
Figura 4. Statusi i punësimit sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike .....	22
Figura 5. Statusi i punësimit sipas rajonit .....	23
Figura 6. Statusi i punësimit sipas vendbanimit .....	23
Figura 7. Sektori i punësimit .....	24
Figura 8. Pagesat institucionale: Zbërthimi i mbështetjes së pranuar .....	27
Figura 9. Kohëzgjatja e papunësisë.....	28
Figura 10. Të hyrat e ekonomive familjare pas tatimit: 2021, 2022 dhe 2023.....	29
Figura 11. Shpenzimet mesatare mujore për gjëra ushqimore: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	31
Figura 12. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	33
Figura 13. Shpenzimet mesatare mujore për transport: Trendet nga viti 2021 deri në 2023.....	36
Figura 14. Shpenzimet mesatare mujore për argëtim: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	37
Figura 15. Shpenzimet mesatare mujore për pajisje elektronike: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	37
Figura 16. Shpenzimet mesatare mujore për arsimim ose trajnim: Trendet nga viti 2021 deri në 2023... ..	38
Figura 17. Shpenzimet mesatare mujore për shërbime të kujdesit shëndetësor: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	39
Figura 18. Perceptimi i përgjithshëm mbi inflacionin gjatë vitit të kaluar .....	40
Figura 19. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve.....	41
Figura 20. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve, sipas gjinisë.....	42
Figura 21. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve, sipas llojit të vendbanimit .....	43
Figura 22. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës .....	44
Figura 23. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës, sipas përkatësisë etnike .....	44
Figura 24. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës, sipas llojit të vendbanimit.....	45
Figura 25. Rritjet e çmimeve sipas kategorive .....	49
Figura 26. Shpenzimet sipas kategorive.....	49
Figura 27. Ndikimi i inflacionit në aftësinë e ekonomive familjare për të blerë mallra sipas kategorive (duke e hequr ND/refuzon të përgjigjet) .....	51
Figura 28. Niveli i shqetësimit për rritjen e nivelit të çmimeve, sipas përkatësisë etnike .....	52
Figura 29. Niveli i shqetësimit për rritjen e nivelit të çmimeve, sipas gjinisë.....	52
Figura 30. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta.....	53
Figura 31. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta, sipas përkatësisë etnike .....	53
Figura 32. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta, sipas gjinisë.....	54
Figura 33. Përdorimi i kartelave të kreditit dhe linjave të kredisë për t'i mbuluar shpenzimet.....	56
Figura 34. Përfitimi nga Programi i Ndhmës Sociale dhe shumat për vitin 2023 .....	59
Figura 35. Përfitimi nga Programi i Ndhmës Sociale dhe shumat për vitin 2023, sipas përkatësisë etnike .....	60
Figura 36. Ndryshimet në Ndhmën Sociale mes viteve 2021 dhe 2022 .....	61
Figura 37. Burimet e Ndhmës Sociale .....	62
Figura 38. Shuma e remitançave të pranura nga viti 2021 deri në vitin 2023.....	63
Figura 39. Arsyet për ndryshimet në remitançat e pranura gjatë viteve.....	64
Figura 40. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth .....	65
Figura 41. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth, zbërthimi sipas përkatësisë etnike.....	66

Figura 42. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth, sipas gjinisë .....	66
Figura 43. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve .....	67
Figura 44. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve, sipas përkatësisë etnike .....	67
Figura 45. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve, sipas gjinisë .....	68
Figura 46. Ndikimi i inflacionit në marrëdhëniet personale ose në jetën shoqërore.....	69
Figura 47. Përjashtimi nga eventet shoqërore për shkak të kufizimeve financiare .....	70
Figura 48. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit	71
Figura 49. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit, sipas përkatësisë etnike .....	72
Figura 50. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit, sipas gjinisë .....	72
Figura 51. Veprimi institucional për trajtimin e inflacionit.....	73
Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit.....	16
Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas llojit të vendbanimit.....	16
Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë .....	16
Tabela 4. Shpërndarja e mostrës sipas moshës .....	16
Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike .....	16
Tabela 6. Të hyrat personale mujore 2021-2023.....	20
Tabela 7. Industria e punësimit: Gjithsej dhe sipas përkatësisë etnike.....	25
Tabela 8. Industria e punësimit sipas gjinisë .....	25
Tabela 9. Burimi kryesor i të hyrave: Gjithsej dhe sipas përkatësisë etnike.....	27
Tabela 10. Të hyrat e ekonomive familjare pas tatimit, sipas përkatësisë etnike për vitin 2023 .....	30
Tabela 11. Shpenzimet mesatare mujore për gjëra ushqimore, sipas përkatësisë etnike: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	32
Tabela 12. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale, sipas përkatësisë etnike: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	34
Tabela 13. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale, sipas vendbanimit: Trendet nga viti 2021 deri në 2023 .....	35
Tabela 14. Perceptimi i përgjithshëm mbi inflacionin gjatë vitit të kaluar, sipas përkatësisë etnike.....	41
Tabela 15. Modelet e shpenzimeve sipas kategorive .....	46
Tabela 16. Ekonomitë familjare nën pragun e varfërisë.....	55
Tabela 17. Përdorimi i kartelave të kreditit dhe linjave të kredisë për t'i mbuluar shpenzimet, sipas përkatësisë etnike.....	57
Tabela 18. Niveli i shqetësimit për borxhin .....	58
Tabela 19. Shuma e remitancave të pranuar nga viti 2021 deri në vitin 2023, sipas përkatësisë etnike.	63

## Shkurtesat

DLLRR	Deficiti i llogarisë rrjedhëse
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
BHV	Bruto të Hyrat Vendore
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

## Përmbledhje ekzekutive

Kjo analizë e Pulsit Publik kishte për qëllim vlerësimin e shkallës në të cilën inflacioni ka ndikuar në mirëqenien ekonomike të banorëve në Kosovë<sup>1</sup>. Përmes grumbullimit të 1,500 anketave të ekonomive familjare dhe hulumtimit të plotë studimor, analiza u përpoq t'i adresonte katër pyetjet e mëposhtme:

1. Si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet ekonomike dhe sa ekonomi familjare janë dukshëm më të varfra në vitin 2023 në krahasim me vitin 2021?
2. A e ka shtuar borxhin e ekonomive familjare rritja e inflacionit?
3. Si i shpjegojnë të hyrat, veçanërisht nga diaspora dhe programet e ndihmës sociale/programet e pensioneve, zgjedhjet e shpenzimeve apo nivelet e të hyrave?
4. Si ka ndikuar inflacioni në cilësinë e përgjithshme të jetës (të matur nëpërmjet: a) pabarazive midis rritjes së shpenzimeve dhe të hyrave duke e ulur kështu fuqinë blerëse të individëve, b) pyetjeve të drejtpërdrejta për të anketuarit në lidhje me mënyrën se si ka ndikuar rritja e çmimeve në cilësinë e jetës së tyre, c) ndikimit të inflacionit në mirëqenien mendore dhe sociale dhe si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet e banorëve) në nivel të ekonomive familjare?

Më poshtë janë të gjeturat kyçe që rezultojnë nga të dhënat e mbledhura prej anketës, si dhe një sërë rekomandimesh:

### **Si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet ekonomike dhe sa ekonomi familjare janë dukshëm më të varfra në vitin 2023 në krahasim me vitin 2021?**

- ✓ Teksa të hyrat e ekonomive familjare përgjithësisht kanë mbetur të pandryshuara gjatë viteve 2021-2023, shpenzimet për nevojat bazë janë rritur gjatë këtyre tre viteve radhazi;
- ✓ Shpenzimet për gjëra ushqimore, të cilat e përbëjnë pjesën më të madhe të konsumit të ekonomive familjare (55% e konsumit siç është vlerësuar nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2022) kanë treguar një rritje, me pjesën më të madhe të shpenzimeve të ekonomive familjare: teksa në vitin 2021, 38.8% e ekonomive familjare nga të dhënat e anketës shpenzuan 200 ose më shumë euro (klasa më e lartë e shpenzimeve në pyetësor), kjo vlerë u rrit në 47.8% dhe deri në 59.5% të ekonomive familjare në vitet 2022 respektivisht 2023.
- ✓ Një trend i ngjashëm vërehet për shërbimet komunale: përqindja e ekonomive familjare që shpenzojnë ndërmjet 50-99 euro (përgjigja më e shpeshtë në pyetësor) u rrit nga 39.8% në 2021 në 45.6% në 2022 dhe në 47.9% në 2023.
- ✓ Edhe kostot e transportit janë rritur, nga 70% që shpenzonin më shumë se 30 euro në 2021 në 80% të ekonomive familjare në 2023.
- ✓ Rritje kanë shënuar edhe shpenzimet për kujdesin shëndetësor: 50.3% e ekonomive familjare raportuan se kishin shpenzime të kujdesit shëndetësor më të larta se 30 euro në vitin 2021 krahasuar me 58.6% që e raportuan të njëjtën gjë për vitin 2023.

---

<sup>1</sup> Për UN, Referencat për Kosovën do të kuptohen të jenë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999).

- ✓ Rritja e çmimeve konfirmohet edhe nga deklarata e pothuajse të të gjithë të anketuarve (99.5%) që pretendojnë se e kanë vërejtur se çmimi i artikujve që blejnë është rritur vitin e kaluar: rritje e çmimit të gjërave ushqimore është raportuar nga 84.4% e të anketuarve; 49.5% për shërbimet komunale; 41.9% për qira; 45.6% për arsim dhe 59.2% për shërbimet/produktet e kujdesit shëndetësor.
- ✓ Si rezultat i ndryshimeve të çmimeve, 44% e ekonomive familjare raportuan se blejnë më pak produkte derisa shpenzojnë më shumë, dhe 42% treguan se po e blejnë të njëjtën sasi të produkteve me të njëjtën sasi të parave (një përqindje e ngjashme e raportoiti këtë kur u pyetën posaçërisht për gjërat ushqimore, shërbimet komunale, kujdesin shëndetësor dhe një përqindje pak më e ulët për shpenzimet e arsimit me 30.7% të të anketuarve).
- ✓ Shumica dërrmuese e banorëve të Kosovës raportuan të jenë të shqetësuar për ndryshimet e çmimeve, përqindja më e lartë është në mesin e komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptasve të Kosovës (94.1% krahasuar me 91.7% të shqiptarëve të Kosovës dhe 92.2% të serbëve të Kosovës).

Vlerësimi i varfërisë:

- Duke i përdorur të dhënat e të hyrave dhe kufirin e varfërisë prej 1.85 euro për person në ditë, shkalla e varfërisë në vitin 2023 vlerësohet të jetë 16%, krahasuar me 17.6% në 2022 dhe 14.5% në 2021. Me fjalë tjera, përqindja e dhënë e familjeve për secilin vit bie nën pragun e varfërisë prej 1.85 euro në ditë.
- **10% e ekonomive familjare ishin dukshëm më të varfra në mes të viteve 2023 dhe 2021, duke treguar një rënie në krahasim me vitin e kaluar.** Krahasuar me vitin 2021, në vitin 2023, një shtesë prej 10% e familjeve të anketuara jetonin nën pragun prej 1.85 euro në ditë, kur përshtaten të dhënat për rritjen e çmimeve.

**A e ka shtuar borxhin e ekonomive familjare rritja e inflacionit?**

- Inflacioni ka çuar në rritjen e borxhit në mesin e ekonomive familjare, duke u mbështetur në kredi dhe kartela krediti për t'i përmbushur nevojat financiare. Për t'i luftuar pasojat e inflacionit në vitin e kaluar 16.1% e të anketuarve kanë përdorur kartela krediti dhe 16.3% e të anketuarve kanë deklaruar se duhet të përdorin kartela krediti ose forma të tjera borxhi për t'i mbuluar shpenzimet e rritura të ekonomive familjare; Vështirësitë financiare janë evidente, me 29% të të anketuarve që i shkurtojnë shpenzimet dhe i vonojnë pagesat e faturave.

**Si i shpjegojnë të hyrat, veçanërisht nga diaspora dhe programet e ndihmës sociale/programet e pensioneve, zgjedhjet e shpenzimeve apo nivelet e të hyrave?**

- Skemat e mbrojtjes sociale mbështesin 21.5% të ekonomive familjare, megjithatë shumica e përfituar është e vogël, me 50.6% që marrin nga 100-199 euro. Ndihma sociale, e cila është e vetmja skemë që i synon të varfrit, nuk është përshtatur për inflacionin, prandaj nuk u arriti synimi i saj për t'i mbështetur nevojat bazë të ekonomive familjare të varfra.
- Remitancat mbeten një burim i rëndësishëm i financave të ekonomive familjare në Kosovë me rreth një të tretën e ekonomive familjare që pranojnë të hyra të tilla. Edhe pse kriza e



çmimeve preku edhe vendet pritëse të diasporës (shumica në Gjermani dhe Zvicër), rënie raportuan vetëm një pjesë e vogël e pranuesve të remitançave. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, fluksi i remitançave është rritur gjatë viteve të vëzhguara në këtë analizë:

**Si ka ndikuar inflacioni në cilësinë e përgjithshme të jetës** (të matur nëpërmjet: a) pabarazive midis rritjes së shpenzimeve dhe të hyrave duke e ulur kështu fuqinë blerëse të individëve, b) pyetjeve të drejtpërdrejta për të anketuarit në lidhje me mënyrën si ka ndikuar rritja e çmimeve në cilësinë e jetës së tyre, c) ndikimit të inflacionit në mirëqenien mendore dhe sociale dhe si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet e banorëve) **në nivel të ekonomive familjare?**

- **Inflacioni ka ndikuar në mirëqenien mendore dhe sociale, duke shkaktuar ndërprerje në aktivitetet rutinore dhe rritje të stresit, duke çuar në cilësi më të ulët të jetës; 46% deklaruan se stresi dhe ankthi i tyre rriten si rezultat i rritjes së çmimeve (një përqindje më e madhe në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës); 36% raportuan ndikim në marrëdhëniet personale ose jetën shoqërore; dhe 23% janë të shqetësuar për mirëqenien e tyre mendore për shkak të inflacionit.**
- U raportuan ulje të aktiviteteve sociale, ulje të kohës së lirë dhe aktiviteteve të lidhura me shëndetin, modelet e çrregullta të gjumit dhe produktivitetit në punë.

Bazuar në të gjeturat kyçe të raportit, propozohen rekomandimet e mëposhtme:

1. **Të zbatohen reformat e tregut të punës dhe të ofrohet mbështetje ekonomike:** Të inkurajohen dhe të mbështeten aktivitetet ndërmarrëse për ta promovuar vetëpunësimin dhe krijimin e vendeve të punës. Të zhvillohen politika për të tërhequr investime të huaja dhe për të stimuluar rritjen në industrinë me intensitet të punës, si prodhimi, ndërtimtaria, tregtia me pakicë dhe mikpritja. T'i kushtohet vëmendje e veçantë mbështetjes së bizneseve në pronësi të femrave.
2. **Të rregullohet ndihma sociale dhe të zgjerohet mbulimi:** Të rishikohen kriteret për heqjen e ekonomive familjare nga Kategoria 2 e Ndhmës Sociale dhe të adresohen kritikrat në lidhje me shportën e vjetëruar të konsumit të përdorur për ta përcaktuar madhësinë e ndihmës sociale. Të reformohen skemat e vazhdueshme të ndihmës sociale për ta përmirësuar mbulimin dhe të merret parasysh përcaktimi i një kufiri për të hyrat shtesë nga puna për të parandaluar që përfituesit të përdorin punësim informal.
3. **Të rritet paga minimale:** Të merret parasysh aprovimi i një propozimi të fundit për ta rritur në 250 euro pagën minimale në Kosovë nga norma aktuale prej 170 eurosh. Të rishikohet dhe të përshtatet rregullisht paga minimale për t'u siguruar që ajo e pasqyron koston e jetesës dhe siguron kompensim të drejtë për punëtorët.
4. **Të rriten përfitimet për fëmijët:** Të rritet gradualisht shuma e përfitimit për fëmijë përtej 10 eurove aktuale në muaj për fëmijë, bazuar në disponueshmërinë e hapësirës fiskale. Kjo politikë mund të ofrojë mbështetje thelbësore për familjet dhe të kontribuojë në mirëqenien e fëmijëve.
5. **Të zbatohen politika të tregut aktiv të punës:** Të mbështetet aktivizimi i përfituesve të ndihmës sociale duke i dhënë përparësi pjesëmarrjes së tyre në masat aktive të tregut të punës të ofruara nga Agjencia e Punësimit dhe ministritë e tjera. Të përshtaten programet

për t'i adresuar nevojat specifike të grupeve të cenueshme, siç janë gratë, komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, personat me nevoja të veçanta dhe nënat vetëushqyese.

6. **Të forcohet mbikëqyrja e ndryshimeve të çmimeve:** Të rriten kapacitetet inspektuese të organeve rregullatore për t'i monitoruar dhe parandaluar rritjet e pajustificuara të çmimeve nga kompanitë. Të monitorohen rregullisht ndryshimet e çmimeve për t'u siguruar që ato përputhen me kushtet e tregut dhe për t'i parandaluar fitimet e tepruara.
7. **Të ndërmerren fushata për vetëdijesim të publikut:** Të lansohen fushata për t'i edukuar ekonomitë familjare për buxhetimin, menaxhimin financiar dhe strategjitë e përballimit gjatë periudhave të inflacionit. Të krijohen platforma për mbledhjen e reagimeve dhe shqetësimeve të banorëve për t'u siguruar që këndvështrimet e tyre të merren parasysh në proceset e politikëbërjes.
8. **Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të interesit të sektorit privat:** Të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet palëve kyçe të interesit për t'i mbështetur kolektivisht individët në nevojë. Bashkëpunimi mund të çojë në politika dhe iniciativa më efektive për ta zbutur ndikimin e rritjes së çmimeve në popullatat e cenueshme.

## Hyrje

Peisazhi bashkëkohor global shënohet nga një sërë sfidash të rëndësishme, si kriza globale e energjisë, konflikti në Ukrainë dhe pandemia COVID-19. Këto ngjarje kanë shkaktuar ndërprerje në ciklet e biznesit, me shumë ekonomi që ende po rimëkëmben nga recesioni prej pandemisë. Marrë parasysh ngecjet në zinxhirët e furnizimit, luftën e vazhdueshme, barrierat tregtare dhe ndërprerje të tjera në sistemet ekonomike, kostoja e jetesës është rritur dhe normat e inflacionit janë rritur, duke rezultuar në një rritje të niveleve të varfërisë dhe një ulje të konsiderueshme të mirëqenies ekonomike të shumë ekonomive familjare.

Padyshim që ekonominë e Kosovës e kanë pllakosur këto probleme. Sipas Bankës Botërore, në dhjetor 2022, norma e inflacionit të ushqimeve në Kosovë ishte 19.4% krahasuar me normën e inflacionit prej 8.8% në janar të të njëjtit vit<sup>2</sup>. Në përgjithësi, norma e përgjithshme e inflacionit në Kosovë, siç raportohet nga të dhënat e Bankës Botërore, ishte 11.6% në vitin 2022, më e larta që nga adoptimi i euros<sup>3</sup>.

Nën dritën e këtyre ngjarjeve, është e domosdoshme të kuptohet se si ka ndikuar inflacioni në Kosovë në mirëqenien ekonomike të individëve dhe pozitën e tyre relative në varfërinë ekonomike. Kështu, kjo analizë e pulsit publik synon ta vlerësojë shkallën në të cilën inflacioni ka ndikuar në mirëqenien ekonomike të banorëve në Kosovë. Përmes mbledhjes së anketave të ekonomive familjare dhe hulumtimit të plotë studimor, analiza synon t'i adresojë pyetjet e mëposhtme:

- Si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet ekonomike dhe sa ekonomi familjare janë dukshëm më të varfra në vitin 2023 në krahasim me vitin 2021?

<sup>2</sup> Përditësimi i Bankës Botërore për Sigurinë Ushqimore. (2023). Në dispozicion në: <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/40ebbf38f5a6b68bfc11e5273e1405d4-0090012022/related/Food-Security-Update-LXXVII-January-26-2023.pdf>

<sup>3</sup> Inflacioni, çmimet e konsumit (% vjetore) – Kosovë. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG?locations=XK>

- A e ka shtuar borxhin e ekonomive familjare rritja e inflacionit?
- Si i shpjegojnë të hyrat, veçanërisht nga diaspora dhe programet e ndihmës sociale/programet e pensioneve, zgjedhjet e shpenzimeve apo nivelet e të hyrave?
- Si ka ndikuar inflacioni në cilësinë e përgjithshme të jetës në nivel të ekonomive familjare?

Seksionet vijuese e ofrojnë një pasqyrë të shqyrtimit të literaturës, të gjeturat e nxjerra nga anketa e ekonomive familjare të kategorizuara në nënseksione, një shpjegim të metodologjisë së përdorur në marrjen e mostrave dhe, për fund, konkluzionet dhe rekomandimet.

## Pasqyra e literaturës

### Treguesit makroekonomikë të Kosovës

I cilësuar shpesh si "vendi më i ri në Evropë", Kosova ka përjetuar një trajektore të rritjes ekonomike graduale dhe të qëndrueshme. Megjithatë, Kosova është përballur me sfida që rrjedhin nga izolimi ekonomik dhe mungesa e njohjes nga Serbia dhe pesë anëtarë të Bashkimit Evropian, përfshirë Qipron, Greqinë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Spanjën, gjë që e ka penguar përparimin e saj ekonomik.

Kosova është klasifikuar me të hyra të mesme të larta në vitin 2020 nga Banka Botërore (vendet me BHY për kokë banori prej 3,996 dollarë deri në 12,375 dollarë)<sup>4</sup>. Në vitin 2021, BPV-ja e Kosovës arriti në 9.41 miliardë dollarë, e matur në dollarë amerikanë aktualë. Edhe pse ajo pësoi një kthim prapa në rritjen e BPV-së në vitin 2020, ekonomia e saj ka qenë në një trajektore të përgjithshme rritëse për sa i përket rritjes ekonomike. Megjithatë, BPV-ja për kokë banori në vitin 2021 ishte në vlerën modeste prej 5,269.8 dollarë, e matur në dollarë amerikanë aktualë, në të njëjtin vit<sup>5</sup>. Krahasuar me vendet e OECD-së, për të cilat BPV-ja mesatare për kokë banori është 42,446 dollarë e matur në dollarë amerikanë aktualë<sup>6</sup>, është evidente se ekonomia e Kosovës ka mungesa në raport me vendet me të hyra të larta, por krahasuar me vitet paraprake, rritja e saj ka qenë me lakore pozitive.

Studimet vlerësojnë se rritja e BPV-së së Kosovës pritet të ngrihet në vitin 2023, duke arritur një shkallë të rritjes prej 3.7%. Përkundër rritjes, ekonomia e Kosovës është e paqëndrueshme dhe e ndjeshme ndaj luhatjeve ndërkombëtare. Kjo i atribuohet një morie faktorësh duke përfshirë mbështetjen në remitanca, importet dhe një shkallë të ulët të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore.

Për shembull, në vitin 2021, remitanca përbënin 18% të BPV-së<sup>7</sup>; DLLRR u përkeqësua në 10.1% të BPV-së (krahasuar me 8.1% në 2021) kryesisht për shkak të çmimeve më të larta të importit<sup>8</sup>; dhe shkalla e fundit e papunësisë ishte 20.7% në vitin 2021<sup>9</sup>. Kjo e fundit është më e rëndë tek të

<sup>4</sup> Banka Botërore. Vendet me të hyra të mesme të larta. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/XT>

<sup>5</sup> Banka Botërore. Të dhëna makroekonomike për Kosovën. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/kosovo>

<sup>6</sup> Banka Botërore. BPV për kokë (US \$ aktuale) – anëtarët e OECD-së. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/kosovo>

<sup>7</sup> Ekonomia e tregimit. Kosova- Pranimi i remitancave të punëtorëve dhe kompensimi i punonjësve (% e BPV). Në dispozicion në:

[https://tradingeconomics.com/kosovo/personal-remittances-received-percent-of-gdp-wb-data.html#:~:text=Personal%20remittances%2C%20received%20\(%25%20of,compiled%20from%20officially%20recognized%20sources](https://tradingeconomics.com/kosovo/personal-remittances-received-percent-of-gdp-wb-data.html#:~:text=Personal%20remittances%2C%20received%20(%25%20of,compiled%20from%20officially%20recognized%20sources).

<sup>8</sup> Banka Botërore në Kosovë. Përmbledhje. Në dispozicion në: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>

<sup>9</sup> Ekonomia e tregimit: Shkalla e papunësisë në Kosovë. Në dispozicion në: <https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate>

rinjtë (15-24 vjeç), për të cilët shkalla e papunësisë është 38.9%, si dhe tek femrat, për të cilat shkalla e punësimit është 16% krahasuar me 44% të meshkujve<sup>10</sup>. Shkalla e vlerësuar e papunësisë për femrat në Kosovë është 22.1%<sup>9</sup>. Megjithatë, kur merret parasysh përkufizimi ekonomik i të papunëve si individë që janë të aftë dhe të gatshëm për të punuar, por të paftë për të gjetur punë, dhe duke e krahasuar këtë të gjetur me shkallën e ulët të punësimit, bëhet e qartë se shkalla aktuale e papunësisë ka gjasa të jetë më e lartë. Kjo mospërputhje mund t'i atribuohet grave që mund të mos kërkojnë në mënyrë aktive punë për shkak të përgjegjësisë dhe detyrave tradicionale që nuk u lejojnë të kërkojnë punë në mënyrë aktive. Si rezultat, shkalla e papunësisë për femrat, megjithëse e rëndësishme, mund të mos e pasqyrojë realitetin.

Për sa i përket niveleve të çmimeve, norma e përgjithshme e inflacionit në Kosovë siç raportohet nga të dhënat e Bankës Botërore kishte vlerën 11.6% në vitin 2022 krahasuar me 3.4% në 2021 dhe 0.2% në 2020. Në vitin 2022, Kosova shënoi normën më të lartë të inflacionit në historinë e saj që nga adoptimi i monedhës euro<sup>2</sup>.

Gjithashtu, informacioni më i fundit në lidhje me shkallën e varfërisë në Kosovë zbulon se në vitin 2017, afërsisht 18% e popullsisë banonte nën kufirin e varfërisë, e cila ishte 1.85 euro në ditë. Për më tepër, 15% e individëve të punësuar në Kosovë u përballën me mundësinë e rrëshqitjes në varfëri. Kjo është vlerë e madhe, por këto përqindje tregojnë një trend pozitiv në krahasim me vitet e mëparshme, pasi që janë 6-7 pikë përqindje më të ulëta se shifrat e regjistruara në vitin 2012<sup>11</sup>.

#### Shkaqet dhe pasojat e inflacionit

Inflacioni, i përcaktuar zyrtarisht si rritja e çmimeve në një ekonomi, është një kërcënim makroekonomik, i cili e rrezikon stabilitetin e një ekonomie. Në vitin 2022, inflacioni parashikohet të jetë një nga kërcënimet më të mëdha për prosperitetin global<sup>12</sup>.

Shkaqet e inflacionit mund t'u atribuohen parimeve themelore të ofertës dhe kërkesës. Inflacioni mund të ndodhë për shkak të goditjeve të ofertës që pengojnë prodhimin, të tilla si rritja e kostove të prodhimit, shpenzimet më të larta të lëndëve të para ose fatkeqësitë natyrore. Ky lloj inflacioni quhet inflacion "i shtyrë prej kostove", ku rritja e çmimit buron nga një shqetësim në zinxhirin e furnizimit. Në të kundërt, inflacioni mund të lindë edhe nga goditjet e kërkesës, qoftë nëpërmjet rritjeve të drejtpërdrejta të kërkesës për produkte ose nëpërmjet politikave monetare ekspansioniste që përfshijnë uljen e normave të interesit ose rritjen e ofertës monetare. Këto politika nxisin në mënyrë indirekte kërkesën për mallra dhe shërbime përfundimtare dhe për rrjedhojë çojnë në një rritje të përgjithshme të çmimeve. Ky lloj inflacioni njihet si inflacion "i tërhequr nga kërkesa". Megjithëse inflacioni "i shtyrë prej kostove" dhe ai "i tërhequr nga kërkesa" janë llojet më të zakonshme, inflacioni mund të nxitet edhe nga pritshmëritë e banorëve. Nëse individët parashikojnë çmime më të larta, ata mund t'i përfshijnë këto pritshmëri në negociatat e

<sup>10</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketë e Fuqisë Punëtore TM2 2022. Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/media/6953/labour-force-survey-q2-2021.pdf>

<sup>11</sup> BERZH. Diagnostikimi i Vendit për Kosovën: Sfidat dhe mundësitë për investime private (2022).

<sup>12</sup> Harvard Business Review. Çka e shkakton inflacionin? (2022). Në dispozicion në: <https://hbr.org/2022/12/what-causes-inflation>

pagave dhe rregullimet kontraktuale të çmimeve, duke krijuar kështu një profeci vetëpërbushëse dhe duke e nxitur normën e inflacionit në periudhën pasuese.

Periudha më e fundit e inflacionit mund t'i atribuohet një kombinimi të faktorëve që e ndikojnë si ofertën ashtu edhe kërkesën. Nga ana e ofertës, ndërprerjet që rrjedhin nga pandemia COVID-19, të tilla si vonesat në transportin detar dhe mungesat e fuqisë punëtore, së bashku me çmimet e përshkallëzuara të energjisë dhe ushqimeve të shkaktuara nga pushtimi i Ukrainës, kanë pasur një efekt kaskadë në çmimet e mallrave të ndryshme në mbarë ekonominë<sup>11</sup>.

Nga ana e kërkesës, shumë vende zbatuan injeksione të konsiderueshme monetare për t'i forcuar ekonominë familjare dhe bizneset në mes të pandemisë, duke e siguruar aftësinë e tyre për t'i përballuar bllokimet dhe humbjet e vendeve të punës. Ky infuzion i parasë në ekonomi e rriti ofertën e përgjithshme të parasë dhe kontribuoi potencialisht në inflacion. Për më tepër, kërkesa për mallra të prekshme përjetoi rritje të konsiderueshme gjatë pandemisë pasi që konsumatorët kishin të hyra të disponueshme, por rrugë të kufizuara për shpenzime për shkak të kufizimeve në shërbime si restorantet<sup>11</sup>.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rritja e çmimeve të konsumit në fund të vitit 2022 në Kosovë mund t'i atribuohet rritjes së çmimeve në sektorë të ndryshëm. Këto përfshijnë shërbimet e transportit, të cilat e patën një rritje të ndjeshme prej 46.9%. Gjithashtu, rritje të dukshme ka pasur edhe tek lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri dhe pelet, me një rritje prej 38.8%. Vajrat dhe yndyrnat u rritën për 30.9%, ndërsa çmimet e qumështit, djathit dhe vezëve u rritën për 27.8%. Rritje të konsiderueshme prej 21.1% shënoi edhe kostoja e bukës dhe e drithërave. Rritje të tjera të dukshme janë vërejtur në çmimet e mishit, mallrave dhe shërbimeve lidhur me mirëmbajtjen e rregullt të ekonomisë, të cilat kanë shënuar rritje përkatëse prej 20.3% dhe 19.5%<sup>13</sup>.

Inflacioni përbën një kërcënim të konsiderueshëm ekonomik për shkak të ndikimit të tij në aspekte të ndryshme të një ekonomie. Së pari, zvogëlon fuqinë blerëse të individëve pasi që pagat zakonisht nuk rriten menjëherë si reagim i periudhave inflacioniste. Si rezultat, banorët mund të blejnë më pak mallra dhe shërbime me të njëjtën shumë të parave, duke çuar në një ulje të standardit të tyre të jetesës. Së dyti, inflacioni e rrit koston e huamarrjes pasi që individët ngurrojnë të huazojnë para, nëse parashikojnë se vlera e parave që marrin në të ardhmen do të zvogëlohet për sa i përket fuqisë blerëse. Kjo i pengon investimet dhe rritjen ekonomike pasi që huamarrja bëhet më pak tërheqëse.

Për më tepër, inflacioni e paraqet një risk pasi që e shkatërron besimin në monedhën e një vendi. Gjatë periudhave të inflacionit të lartë, shpesh ekziston një ndjenjë e rritjes së pasigurisë në publik. Banorët bëhen skeptikë për stabilitetin dhe vlerën e ardhshme të monedhës së tyre, gjë që mund të çojë në një humbje të besimit në ekonominë e përgjithshme.

---

<sup>13</sup> Prishtina Insight. Kosova mbyll vitin 2022 me inflacion rekord (2022). Në dispozicion në: [https://prishtinainsight.com/kosovo-ends-2022-with-record-inflation/#:~:text=%E2%80%9CThis%20is%20mainly%20explained%20by,\(19.5%25\)%E2%80%9D%20KAS%20said.](https://prishtinainsight.com/kosovo-ends-2022-with-record-inflation/#:~:text=%E2%80%9CThis%20is%20mainly%20explained%20by,(19.5%25)%E2%80%9D%20KAS%20said.)

Për më tepër, inflacioni zakonisht rezulton në rishpërndarje të të hyrave brenda shoqërisë. Banorët që mbështeten në të hyra fikse, si fondet e pensione apo ndihma sociale, janë veçanërisht të cenueshëm ndaj efekteve negative të inflacionit. Teksa çmimet rriten, fuqia e tyre blerëse zvogëlohet, duke e bërë më sfiduese për ta përballimin e nevojave dhe ruajtjen e standardit të tyre të jetesës. Kjo rishpërndarje e të hyrave mund t'i përkeqësojë pabarazitë ekzistuese dhe të krijojë barrë financiare shtesë për ata që janë tashmë të pafavorizuar ekonomikisht.

Ndikimi i inflacionit në mirëqenien ekonomike të ekonomive familjare: Çka thonë studimet Hulumtimet tregojnë se ndikimi i inflacionit tek ekonomitë familjare ndryshon dhe, për fat të keq, ekonomitë familjare me të hyra më të ulëta priren ta mbajnë barrën më të madhe financiare. Kjo ndodh kryesisht për shkak se ekonomitë familjare me të hyra më të ulëta zakonisht ndajnë një pjesë më të madhe të buxhetit të tyre drejt mallrave dhe shërbimeve që ndikohen ndjeshëm nga inflacioni.

Një studim i fundit i kryer në Shtetet e Bashkuara në fund të vitit 2021, për shembull, thekson se ekonomitë familjare me të hyra më të ulëta përjetojnë një rritje të përafërt të shpenzimeve prej 7%, ndërsa ekonomitë familjare me të hyra më të larta përballen me një rritje prej rreth 6%<sup>14</sup>.

Një studim i ngjashëm i kryer nga Banka Qendrore Evropiane vë në dukje se ekonomitë familjare me nivele të ndryshme të hyrash dhe rrethana financiare kanë kapacitete të ndryshme për t'u përshtatur me ndikimin e goditjeve inflacioniste. Përveç reduktimit të konsumit të tyre, ekonomitë familjare mund të marrin hua, t'i përdorin kursimet, t'i rrisin orët e punës dhe të negociojnë për paga më të larta. Megjithatë, ekonomitë familjare me të hyra më të ulëta shpesh kanë aftësi të kufizuar ose aspak aftësi për ta ulur konsumin, për qasje në kursime, për të marrë kredi ose për të siguruar paga më të larta. Për më tepër, ato përballen me një risk më të lartë të papunësisë nëse presionet inflacioniste çojnë në një rënie ekonomike, veçanërisht kur inflacioni është i nxitur kryesisht nga goditjet e ofertës së huaj. Studimi thekson për shembull se pabarazia në inflacion e përjetuar nga ekonomitë familjare në klasën e 20% me të hyrat më të ulëta dhe klasën e 20% me të hyrat më të larta, arriti kulmin e në fund të vitit 2022, duke arritur nivelin më të lartë të vërejtur që nga mesi i viteve 2000<sup>15</sup>.

Në mënyrë të ngjashme, një raport i hartuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në vitin 2022 thekson se rritja e inflacionit po shkakton një rënie të rritjes së pagave reale në disa vende. Kjo rënie është veçanërisht e rëndësishme për individët me të hyra më të ulëta dhe ekonomitë e tyre familjare, pasi që ata ndajnë një pjesë më të madhe të të hyrave të tyre drejt mallrave dhe shërbimeve esenciale, të cilat priren të përjetojnë rritje më të larta të çmimeve në krahasim me artikujt jo esenciale. Për shembull, siç thuhet në raport, në Meksikë, ekonomitë familjare në klasën

---

<sup>14</sup> Penn Wharton. Ndikimi i inflacionit sipas të hyrave të ekonomive familjare. (2021). Në dispozicion në: <https://budgetmodel.wharton.upenn.edu/issues/2021/12/15/consumption-under-inflation-costs>

<sup>15</sup> Banka Qendrore Evropiane. Ndikimi i rritjes së fundit të inflacionit nëpër ekonomi familjare. (2023). Në dispozicion në: [https://www.ecb.europa.eu/pub/economic-bulletin/articles/2023/html/ecb.ebart202303\\_02~037515ed7d.en.html](https://www.ecb.europa.eu/pub/economic-bulletin/articles/2023/html/ecb.ebart202303_02~037515ed7d.en.html)

e 10% me të hyrat më të ulëta, të njohur si decili i poshtëm, ndajnë 42% të të hyrave të tyre për ushqim, ndërsa ato në decilin e lartë shpenzojnë vetëm 14% për ushqim<sup>16</sup>.

Inflacioni i vazhdueshëm padyshim që do të ketë efekte afatgjata edhe në mirëqenien ekonomike të ekonomive familjare në Kosovë. Kjo cenueshmëri është pjesërisht për shkak të varësisë së lartë të Kosovës ndaj ekonomive evropiane dhe kufizimeve të saj në zbatimin e politikës monetare diskrecionale për ta frenuar inflacionin. Për më tepër, studimet vlerësojnë se ndikimi kolektiv i rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve në buxhetet e ekonomive familjare mund të përbëjë rreth 9.5% deri në 18% të rritjes totale të shpenzimeve në të hyrat e ekonomive familjare<sup>17</sup>. Rritja e pritshme e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, dhe veçanërisht e çmimeve të energjisë, ka gjasa që t'i shtyjë shumë ekonomi familjare drejt varfërisë, veçanërisht kur merret parasysh se edhe në mungesë të masave inflacioniste, 40% e popullsisë së Kosovës tashmë vuan nga varfëria energjetike<sup>18</sup>.

Marrë parasysh gjendjen e pasigurt ekonomike të Kosovës, luftën e vazhdueshme me varfërinë energjetike, ekspozimin dhe ndjeshmërinë ndaj ekonomive evropiane, si dhe masat e kufizuara të politikës monetare, është e qartë se shumë familje do të preken ndjeshëm nga inflacioni i fundit. Këto rrethana ka gjasa ta çrregullojnë mirëqenien dhe stabilitetin e tyre ekonomik.

## Metodologjia

Studimi ndjek një metodologji të marrjes së mostrave të kuotave me 1,500 anketa të mbledhura me ekonomitë familjare nga të shtatë rajonet e Kosovës, 10% e mostrës (150 individë) u mbledhën nga komuniteti serb i Kosovës, 10% (150 individë) nga komunitetet e tjera duke i përfshirë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, dhe 1,200 anketat e mbetura me shqiptarë të Kosovës.

Shpërndarja e intervistave në mostër është përcaktuar duke i përdorur të dhënat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Kjo është bërë pas grumbullimit të të dhënave përmes peshimit të të dhënave. Në veçanti, të dhënat janë peshuar sipas gjinisë dhe rajonit në mënyrë që të dhënat e mostrës të përkojnë me të dhënat për popullatën të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat u mbledhën bazuar në faktorë të ndryshëm, duke përfshirë rajonin, gjininë, moshën dhe përkatësinë etnike, duke i përdorur të dhënat nga Regjistrimi i vitit 2011. Marrë parasysh popullsinë e vlerësuar prej 1,773,971 banorësh në Kosovë për vitin 2021, marzhi i gabimit për mostrën e përgjithshme prej 1,500 intervistash, me një nivel besimi prej 95%, është afërsisht  $\pm 2.53\%$ .

---

<sup>16</sup>Organizata Ndërkombëtare e Punës. Raporti Global për Pagat - 2022-2023: Ndikimi i inflacionit dhe COVID-19 në paga dhe fuqi blerëse. Në dispozicion në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_protect/---protrav/---travail/documents/publication/wcms\\_862569.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---travail/documents/publication/wcms_862569.pdf)

<sup>17</sup> UNDP. Vlerësimi i ndikimit të krizës së Ukrainës në Kosovë: Një ushtrim i Parashikimit Strategjik duke përfshirë projeksione të bazuara në skenarë (2022). Në dispozicion në: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-03/Assessing%20the%20Impact%20of%20the%20Ukraine%20crisis%20on%20Kosovo%20-%20An%20Exercise%20in%20Strategic%20Foresight%20Including%20Scenario-Based%20Projections.pdf>

<sup>18</sup>GIZ. Varfëria energjetike në Kosovë. (2021). Në dispozicion në: <https://www.giz.de/en/downloads/giz2023-en-factsheet-energy-poverty.pdf>

Tabelat e mëposhtme e paraqesin shpërndarjen e peshuar të mostrës sipas rajonit, llojit të vendbanimit, gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike.

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit

Rajoni	Përqindja (të dhëna zyrtare)	Intervista n=1500
Gjakovë	11%	165
Prishtinë	28%	420
Gjilan	11%	165
Prizren	19%	285
Pejë	10%	150
Ferizaj	10%	150
Mitrovicë	11%	165
Gjithsej	100%	1,500

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas llojit të vendbanimit

Lloji i vendbanimit	Përqindja (të dhëna zyrtare)	Intervista n=1500
Rural	60%	900
Urban	40%	600
Gjithsej	100%	1,500

Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë

Gjinia	Përqindja (të dhëna zyrtare)	Intervista n=1500
Femra	48%	720
Meshkuj	52%	780
Gjithsej	100%	1,500

Tabela 4. Shpërndarja e mostrës sipas moshës

Mosha	Përqindja (të dhëna zyrtare)	Intervista n=1500
18-24	20%	300
25-34	25%	375
35-44	20%	300
45-54	15%	225
55-64	10%	150
65 e lart	10%	150
Gjithsej	100%	1,500

Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas përkatësisë etnike

Përkatësia etnike	Përqindja (të dhëna zyrtare)	Intervista n=1500
Shqiptarë të Kosovës	80%	1,200
Serbë të Kosovës	10% (përforcues)	150



Të tjerë në Kosovë	10% (përforcues)	150
Gjithsej	100%	1,500

Anketa kishte gjithsej pesë module:

- Niveli i të anketuarve: Një modul që ka të bëjë me informatat demografike të të anketuarve.
- Niveli i të anketuarve: Një modul në lidhje me informatat e punësimit të të anketuarve.
- Niveli i ekonomive familjare: Një modul që pyet për të hyrat e përgjithshme të ekonomisë familjare së të anketuarit dhe statusin e punësimit të anëtarëve të ekonomisë familjare.
- Niveli i ekonomive familjare: Një modul në lidhje me shpenzimet e ekonomive familjare në nivel të ekonomive familjare.
- Niveli i të anketuarve në lidhje me perceptimin e ekonomisë familjare: Një modul në lidhje me perceptimin e të anketuarve në lidhje me mënyrën si i ka ndryshuar inflacioni zgjedhjet e tyre dhe cilësinë e përgjithshme të jetës në fushat e modeleve të të hyrave dhe shpenzimeve, borxhit, ndihmës sociale, remitancave të emigrantëve, ndikimit të rritjes së çmimeve në mirëqenien mendore dhe fizike të të anketuarit, dhe një pyetje opinioni lidhur me besimin e të anketuarit se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret ekzekutivi i Kosovës për ta adresuar inflacionin.

Për ta plotësuar anketën të anketuarit **u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme duke e përdorur metodologjinë e ditëlindjes së fundit**: për ta plotësuar anketën u përzgjedh anëtari i ekonomisë familjare me ditëlindjen më të afërt (të fundit). Si të tilla, pyetjet e bëra janë **ose për nivel të ekonomive familjare ose për nivel individual**. Sa herë që janë bërë pyetje në nivel individual, ato janë bërë vetëm për të anketuarin. Anketa nuk përfshinte renditjen ose regjistrimin veçmas të të dhënave demografike të secilit anëtar të ekonomisë familjare në një format të strukturuar (zakonisht i quajtur listë) kur bëheshin pyetje individuale. Në vend të kësaj, anketa u fokusua vetëm në mbledhjen e informatave për të hyrat e të anketuarit.

## Rezultatet

### Informata demografike

Të dhënat e mbledhura tregojnë se 50.6% ishin meshkuj dhe 49.4% femra pas peshimit të të dhënave. Për më tepër, moshja e të anketuarve shkon nga 18 deri në 85 vjeç, me një moshë mesatare prej 43.42 vjeç. Këto statistika ofrojnë një pasqyrë të shpërndarjes së moshës brenda mostrës së anketuar, duke treguar një spektër të gjerë të moshave në mesin e pjesëmarrësve.

Analiza e përkatësisë etnike të të anketuarve tregon se shumica e të anketuarve janë identifikuar si shqiptarë të Kosovës, duke përbërë 89.4% të përgjigjeve. Etnia serbe përfaqëson 5.3% të të anketuarve, etnitë rome dhe ashkali secila kanë përmasa më të vogla, me një përqindje kumulative prej 5.2%. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, 93% e popullsisë së Kosovës përbëhet nga shqiptarë të Kosovës, 1.6% nga boshnjakë të Kosovës, 1.5% nga serbë të Kosovës, 1% nga romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës<sup>19</sup>.

<sup>19</sup> Libri Botëror i Fakteve. Kosova: Përmbledhja e vendit. Në dispozicion në: <https://www.cia.gov/the-world-factbook/countries/kosovo/summaries/>

Figura 1. Përkatësia etnike e të anketuarve




Analiza e statusit martesor të të anketuarve zbulon se përqindja më e madhe e të anketuarve, që përbën 67% të mostrës, raportuan se janë të martuar. Veç kësaj, 23% e të anketuarve e identifikuan veten si beqarë, duke sugjeruar një pjesë të konsiderueshme të individëve të pamartuar brenda mostrës së anketuar. Një përqindje e vogël e të anketuarve, 2%, raportuan se ishin në një lidhje, por nuk jetonin së bashku, ndërsa një përqindje e barabartë raportuan se jetonin me një partner ose bashkëjetonin. Përqindjet e të anketuarve që u identifikuan si të martuar, por të ndarë dhe të shkurorëzuar, ishin të dyja 1%. Në fund, 5% e të anketuarve raportuan se ishin të ve.

Të gjeturat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e mostrës të anketuar, 71%, raportuan se kishin fëmijë. Kjo tregon se prindërimi është i përhapur brenda grupit të mostrës.

Për më tepër, madhësia mesatare e ekonomisë familjare prej 4.89 anëtarësh tregon se, mesatarisht, çdo ekonomi familjare përbëhet nga afërsisht pesë individë. Prania e fëmijëve dhe madhësia më e madhe e ekonomisë familjare mund të ketë implikime për faktorë të tillë si nevojat për banim, dinamikat e familjes dhe shpërndarja e burimeve brenda këtyre ekonomive familjare.

Figura 2. Numri i anëtarëve që jetojnë në ekonomi familjare



#### Informata për punësimin e të anketuarve

Veç kësaj, për qëllimin e kësaj analize, ishte thelbësore të kuptohet edhe shpërndarja e të hyrave të të anketuarve. Andaj, të anketuarve të anketës iu kërkua që t'i raportojnë të hyrat mesatare mujore vetanake/personale neto si dhe të hyrat e ekonomive familjare për tre vjet, nga 2021 deri në 2023. Ky seksion i paraqet të gjeturat mbi të hyrat mesatare mujore neto vetëm të të anketuarve, ndërsa seksioni për “të hyrat e ekonomive familjare” e trajton profilin demografik për nivelin e ekonomive familjare. Përqindja e individëve që raportojnë të hyra në intervalin 0 deri në 249 euro mbeti relativisht e qëndrueshme gjatë viteve, me 17.7% në 2021, 18.8% në 2022 dhe 19.3% në 2023. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e të anketuarve në intervalin e të hyrave prej 250 euro deri në 399 euro tregoi luhataje të lehta, me 12.7% në 2021, 12.5% në 2022 dhe 11.7% në 2023.

Veçanërisht, përqindja e individëve që fitojnë midis 400 dhe 799 euro në muaj u rrit me kalimin e viteve, nga 21.3% në 2021 në 23.1% në 2022 dhe 23.7% në 2023. Në të kundërtën, përqindja e të anketuarve që fitojnë të hyra më të larta (800-1199 euro, 1200-1999 euro, 2000 euro ose më shumë) mbeti relativisht konsistente, vetëm me ndryshime të vogla.

Për më tepër, të dhënat tregojnë një ulje të përqindjes së individëve që nuk i raportojnë të hyrat personale ndër vite, nga 43.5% në 2021 në 40.6% në 2022 dhe 39.5% në 2023. Kjo sugjeron një rënie graduale të përqindjes së të anketuarve pa të hyra personale, duke treguar potencialisht përmirësimin e kushteve ekonomike ose rritjen e mundësive të punësimit gjatë viteve.

Përgjithësisht, këto të gjetura ofrojnë një pasqyrë të shpërndarjes së të hyrave ndërmjet mostrës të anketuar gjatë tre viteve, duke shfaqur trende të tilla si stabiliteti në klasat më të ulëta të të

hyrave, një rritje në intervalin 400-799 euro, një prani konsistente e fituesve të të hyrave më të larta dhe një rënie graduale të përqindjes së individëve pa të hyra personale.

*Tabela 6. Të hyrat personale mujore 2021-2023*

	2021	2022	2023
0 euro - 249 euro	17.7%	18.8%	19.3%
250 euro - 399 euro	12.7%	12.5%	11.7%
400 euro - 799 euro	21.3%	23.1%	23.7%
800 euro - 1199 euro	3.7%	4.2%	4.5%
1200 euro - 1999 euro	0.7%	0.6%	0.9%
2000 euro ose më shumë	0.3%	0.3%	0.4%
Nuk kam pasur të hyra vetanake/personale këtë vit	43.5%	40.6%	39.5%
Numri i të anketuarve (duke hequr Nuk e di/Refuzon të përgjigjet)	1,453	1,459	1,462

Kur merren parasysh të hyrat mesatare mujore, ka pasur një rritje graduale gjatë periudhës trevjeçare. Në vitin 2021, të hyrat mesatare mujore janë raportuar të jenë 205.8 euro. Kjo shifër u rrit në 216.8 euro në vitin 2022, duke përfaqësuar një rritje prej rreth 5.4%. Për më tepër, në vitin 2023, të hyrat mesatare mujore u rritën më tej në 231.3 euro, duke reflektuar një rritje shtesë prej rreth 6.7% krahasuar me një vit më parë. Këto rritje të përqindjes ofrojnë njohuri të vlefshme për tendencat e ndryshimit të të hyrave me kalimin e kohës, duke sugjeruar një trend pozitiv të rritjes së të hyrave brenda mostrës të anketuar. Kjo analizë e nxjerr në pah trajektoren e përgjithshme rritëse të të hyrave mesatare mujore nga viti 2021 në 2023.

Në seksionet në vijim, analiza paraqitet në mënyrë holistike si dhe e zbërthyer sipas variablave të caktuara kur është e përshtatshme. Në rastet kur pyetjet janë parashtruar në nivel të ekonomisë familjare, analiza nuk ofron zbërthim të bazuar në variabla individuale demografike.


Për më tepër, madhësia përfundimtare e mostrës së papeshuar i bashkëngjitet çdo grafiku dhe përgjigjet me “nuk e di” ose “refuzoj të përgjigjem” janë hequr nga analiza.

### Të hyrat dhe punësimi i të anketuarve dhe ekonomive familjare

Të anketuarve iu kërkua të përgjigjen në pyetjet që kanë të bëjnë me informatat e tyre të punësimit për ta kuptuar më mirë shpërndarjen e mostrës, arsyet e mospunësimit nëse janë të pranishme, dhe industritë ku individët janë të punësuar.



Në lidhje me statusin e tyre të punësimit, individët u nxitën të përgjigjen nëse ishin të punësuar një vit më parë, gjatë periudhës maj-qershor 2022, si dhe gjatë periudhës maj-qershor 2023. Në maj-qershor 2023, përqindja e të anketuarve që raportuan se ishin të punësuar u rrit lehtë në 34.2% krahasuar me 33.7% një vit më parë. Kjo tregon një përmirësim të lehtë në shkallën e përgjithshme të punësimit.

Figura 3. Statusi i punësimit: 2022 deri 2023



Kur krahasohen të njëjtat të dhëna sipas përkatësisë etnike për vitin 2023, komuniteti serb kishte një nivel dukshëm më të lartë të punësimit (63.9%) në krahasim me homologët e tyre shqiptarë (32%) dhe romë, ashkali, egjiptas (36%). Analiza sipas gjinisë tregon se shkalla e punësimit të femrave është shumë më e vogël (21.1%) krahasuar me meshkujt (47.4%). Megjithatë, marrë parasysh madhësinë e vogël të mostrës së të dhënave të mbledhura me serbët e Kosovës (n=150) dhe komunitetet e tjera (n=150), këshillohet kujdes kur interpretohen të dhënat dhe nuk këshillohet përgjithësimi për popullsinë.


Figura 4. Statusi i punësimit sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike



Për sa i përket shtrirjes rajonale, Mitrovica e ka përqindjen më të lartë të individëve të punësuar (44.7%), e ndjekur nga Prishtina (39.5%) dhe Gjilani (38.5%). Peja (35.1%) dhe Prizreni (28.2%) gjithashtu kanë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë të punësuar. Shkalla e vetëpunësimit është relativisht më e ulët në të gjitha qytetet, me Gjakovën që e ka përqindjen më të lartë (10.9%). Të dhënat tregojnë gjithashtu variacione në shkallën e papunësisë, ku Mitrovica e ka përqindjen


më të lartë të individëve që kërkojnë punë në mënyrë aktive (13.5%). Individët e pensionuar janë më të përhapur në Ferizaj (24.9%) dhe Gjakovë (25%), ndërsa Prizreni (32.7%) dhe Ferizaj (28.2%) kanë përqindjen më të lartë të amvisëve.

Figura 5. Statusi i punësimit sipas rajonit




Për sa i përket përhapjes rurale/urbane, zonat rurale kishin më pak raportime të individëve të punësuar dhe shanse më të larta për të qenë amvisë.

Figura 6. Statusi i punësimit sipas vendbanimit



Për sa i përket sektorit të punësimit, 71% e mostrës punojnë për sektorin privat dhe 29% për sektorin publik.

Figura 7. Sektori i punësimit



Për sa i përket industrisë së punësimit të mostrës, ndër sektorët e listuar, industria/prodhimi e kishte përfaqësimin më të lartë me 16.5%. Ndërtimtaria zë 13.5%, duke treguar se një pjesë e dukshme e mostrës punon në sektorin e ndërtimtarisë. Tregtia me pakicë dhe industria e gastronomisë dhe hotelerisë ishin gjithashtu të spikatura, me përqindje përkatësisht prej 12.0% dhe 10.0%, duke e reflektuar rëndësinë e këtyre sektorëve në ofrimin e mundësive të punësimit. Pjesa e mbetur paraqitet në detaje në tabelën e mëposhtme. Duke i krahasuar këto të dhëna me Anketën e Fuqisë Punëtore, bujqësia siguron 2% të punësimit, puna në tregtinë me shumicë/pakicë 15.5%, transporti dhe magazinimi 2.3% e kështu me radhë<sup>20</sup>. Mospërputhja e mundshme që lind midis të dhënave të mostrës dhe të dhënave zyrtare të AFP-së mund t’u atribuohet faktorëve të ndryshëm. Së pari, grupimi i industrisë në lidhje me kategoritë e industrisë nuk ishte gjithmonë identik me kategoritë zyrtare të AFP-së. Së dyti, vetëm individëve të punësuar në sektorin privat iu kërkua që ta deklaronin industrinë e tyre të punësimit, ku mund të kishin shtuar edhe një kategori “tjetër” të një industrie të vetëdeklaruar.

Sa i përket përkatësisë etnike, komuniteti shqiptar i Kosovës është më së shumti i punësuar në aktivitete të ndërlidhura me prodhimtarinë (16.4%) pasuar nga ndërtimtaria (13.3%). Komuniteti serb i Kosovës është më së shumti i punësuar në aktivitete prodhuese (22%) pasuar nga transporti

<sup>20</sup> Anketa për Pjesëmarrjen në Fuqinë Punëtore. TM1 2022. Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/media/7528/labour-force-survey-q1-2022.pdf>



dhe komunikimi (13.9%). Sa i përket komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, industria me punësimin më të lartë është ndërtimtaria (16.2%) pasuar nga tekstilet/veshjet (14.5%).

Për sa i përket gjinisë, meshkujt kishin më shumë gjasa të punësoheshin në industrinë e prodhimit (19.1%) dhe femrat në tregtinë me pakicë (21.4%).

*Tabela 7. Industria e punësimit: Gjithsej dhe sipas përkatësisë etnike*

	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Bujqësi	6.0%	6.4%	11.6%
Industri/Prodhimtari	16.4%	22.2%	8.9%
Tekstile/Veshje	4.6%	0%	14.5%
Ndërtimtari	13.3%	10.4%	16.2%
Tregti me pakicë	12.5%	6.9%	14.8%
Tregti me shumicë	3.8%	6.9%	0.0%
Industri e gastronomisë dhe hotelerisë	10.5%	2.9%	6.3%
Transport/komunikacion	5.9%	13.9%	2.3%
Shërbime profesionale	10.6%	9.9%	2.3%
Patundshmëri	0.3%	0.0%	0.0%
Tjetër	16.2%	20.3%	21.1%
Gjithsej	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>
Numri i vëzhgimeve	<b>345</b>	<b>47</b>	<b>30</b>

*Tabela 8. Industria e punësimit sipas gjinisë*

	Meshkuj	Femra
Bujqësi	7.7%	1.4%
Industri/Prodhimtari	19.1%	9.5%
Tekstile/Veshje	2.9%	9.9%
Ndërtimtari	18.6%	0%
Tregti me pakicë	8.5%	21.4%
Tregti me shumicë	3.2%	5.4%
Industri e gastronomisë dhe hotelerisë	9.5%	11.2%
Transport/komunikacion	7.7%	1.8%
Shërbime profesionale	8.6%	15.4%
Patundshmëri	0.4%	0.0%
Tjetër	13.7%	23.9%
Gjithsej	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>
Numri i vëzhgimeve	<b>282*</b>	<b>126*</b>

Shkalla e përgjithshme e punësimit u përmirësua lehtë, me 34.2% të punësuar në maj-qershor 2023 krahasuar me 33.7% një vit më parë. Vetëpunësimi gjithashtu u rrit lehtë, duke treguar rritje në aktivitetet ndërmarrëse. Individët e papunë që kërkojnë punë në mënyrë aktive u pakësuan, duke sugjeruar një përmirësim shumë të lehtë të tregut të punës, ndërsa u pakësuan edhe të papunët që nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive.

Shumica e të anketuarve punonin në sektorin privat dhe arsyet për humbjen e vendeve të punës ishin të ndryshme. Përfaqësimi i industrisë ishte i larmishëm, me industrinë/prodhimin, ndërtimtarinë, tregtinë me pakicë dhe mikpritjen që ishin më të spikatura. Përfaqësim të dukshëm kishin shërbimet profesionale dhe bujqësia, ndërsa prezencën më të ulët e kishin pronat e paluajtshme.

#### Të hyrat e ekonomive familjare dhe punësimi

Duke qenë se objektivi i këtij raporti është t'i vlerësojë efektet e inflacionit në mirëqenien e ekonomive familjare, u kryen një sërë hetimesh për të mbledhur informata edhe për të hyrat edhe për situatën e punësimit të individëve brenda ekonomive familjare.

Tabela e mëposhtme i paraqet të gjeturat kyçe në lidhje me burimet kryesore të të hyrave për ekonomitë familjare, ku mund të zgjidheshin përgjigje të shumta. Shumica e ekonomive familjare (73.1%) raportuan pagën/mëditjet si burimin kryesor të të hyrave të tyre, duke treguar një mbështetje të konsiderueshme në të hyrat e bazuara në punësim. Të hyrat nga biznesi zinin 7.9%, duke sugjeruar se një pjesë e të hyrave të gjeneruara të ekonomive familjare vjen nga ndërmarrjet afariste. Të hyrat nga bujqësia, në masën 8.5%, tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e ekonomive familjare kanë të hyra nga aktivitetet bujqësore. Të hyrat nga investimet dhe të hyrat nga qiraja ishin relativisht të ulëta në 0.6% dhe 0.5% respektivisht.

Për një të pestën e ekonomive familjare, ndihma institucionale është burimi kryesor i të hyrave, duke theksuar përqindjen e përafërt të ekonomive familjare që varen nga transferet institucionale për të hyra. Gjithashtu, 19.1% raportuan se remitancat janë burimi kryesor i të hyrave.

Sa i përket përkatësisë etnike, 93.4% e serbëve të Kosovës raportuan se kishin pagën/mëditjet si burim kryesor të të hyrave, pasuar nga të hyrat bujqësore si të hyra kryesore për 14.2% të ekonomive familjare serbe të Kosovës. Për shqiptarët e Kosovës, në 71.8% të rasteve, burimi primar i të hyrave ka ardhur nga paga/mëditjet, pasuar nga ndihma sociale me 21.2%. Për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, 59.5% e të hyrave kanë ardhur në formë të pagave dhe 45.3% nga ndihma sociale. Të gjeturat e fundit mund të tregojnë rezultate më të dobëta të punësimit për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës dhe mbështetje të madhe në ndihmë sociale.

Tabela 9. Burimi kryesor i të hyrave: Gjithsej dhe sipas përkatësisë etnike


	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës, Egjiptas të Kosovës	Gjithsej
Paga/mëditje	53.2%	63.5%	36.8%	73.1%
Të hyra biznesi	5.8%	4.1%	5.8%	7.9%
Të hyra nga bujqësia	6.3%	9.7%	1.4%	8.5%
Të hyra nga investimet	0.3%	1.5%	0.4%	0.6%
Të hyra nga dhënia me qira	0.4%	0%	0%	0.5%
Pagesa institucionale:	15.7%	9.6%	28.1%	20.7%
Remitanca	14.6%	0.8%	20.5%	19.1%
Hua	0.3%	9.1%	0%	1.1%
Lypje në rrugë	0.4%	0%	1.3%	0.4%
Tjetër	3.0%	1.9%	5.7%	4.9%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100%</b>
<b>Numri i vëzhgimeve</b>	<b>1,200</b>	<b>150</b>	<b>150</b>	<b>1,500</b>

Më pas, në mesin e ekonomive familjare që u përgjigjën se marrin të hyra/transfere institucionale<sup>21</sup>, burimet kyçe për këtë ndihmë i përfshijnë pensionet (69.2% e ekonomive familjare), 14.3% kanë marrë ndihmë sociale - një përqindje më e lartë se 6.7% sipas të dhënave administrative të MFPT<sup>22</sup> (anketimi nuk pyeti nëse Kategoria 1 apo 2), pasuar nga pensionet e lidhura me konfliktin (7.5% e ekonomive familjare), pensionet e invaliditetit dhe kompensimet raportohen si burim primar i të hyrave për 6.9% të ekonomive familjare që kanë marrë mbështetje nga mbrojtja sociale. Pak më shumë se një e pesta e ekonomive familjare treguan burime të tjera ndihme, duke i përfshirë pensionet e prindërve/vjehërrive që nuk jetojnë domosdoshmërisht në atë ekonomi familjare, bamirësi/marrjen e ndihmës nga fqinjët/të afërmit dhe skemat e ndihmës për fëmijët.

Figura 8. Pagesat institucionale: Zbërthimi i mbështetjes së pranuar


<sup>21</sup> Pagesat institucionale ose "transferet qeveritare" janë pagesa të kryera për të cilat nuk kërkohen mallra ose shërbime aktuale ose të ardhshme. Ato përfshijnë benefitet e sigurimeve sociale, benefitet e sigurimit të papunësisë dhe pagesat e mirëqenies sociale.

<sup>22</sup> ASK, 2023, Statistikat e mirëqenies sociale: <https://ask.rks-gov.net/media/7571/statistikat-e-mireqenies-sociale-maj-2023-shqip.pdf>



Ndër ekonomitë e anketuara familjare, 73.2% e ekonomive familjare raportuan se kishin individë të papunë: 73% në mesin e ekonomive familjare shqiptare të Kosovës, 65.4% të atyre serbe të Kosovës dhe 80.9% në ekonomitë familjare rome, ashkali dhe egjiptase të Kosovës. Shumica e individëve të papunë (94%) brenda ekonomive familjare ishin të papunë afatgjatë (për më shumë se 12 muaj).

Figura 9. Kohëzgjatja e papunësisë




Mungesa e mundësive të punës ishte arsyeja më e zakonshme (për 46.5% të të papunëve), pasuar nga 29.8% që tregojnë kujdesin për fëmijët ose anëtarët e familjes, ndërsa ndjekja e arsimit ose trajnimit raportohet si arsye për papunësi për 8.7% të individëve të papunë.

Për sa i përket të hyrave nominale pas tatimit të ekonomive familjare , të gjeturat zbulojnë se në vitin 2021, përqindja më e lartë e ekonomive familjare ra në intervalin 400-799 euro të të hyrave,

duke përbërë 43.2% të përgjigjeve. Megjithatë, kjo përqindje u rrit pak në 43.5% në 2022 dhe përsëri në 43.0% në 2023, duke treguar stabilitet relativ në këtë klasë të të hyrave ndër vite. Intervali i të hyrave 800-1199 euro mbeti gjithashtu konsistent, me 18.6% në 2021, 18.7% në 2022 dhe një rritje të lehtë në 19.8% në 2023. Anasjelltas, përqindja e ekonomive familjare në klasat e të hyrave më të ulëta u ul lehtë me kalimin e kohës. Në intervalin e të hyrave 0-249 euro, pati një rënie nga 6.7% në 2021 në 6.5% në 2022, dhe më tej në 6.0% në 2023. Një rënie vërehet edhe për ekonomitë familjare me të hyra në intervalin prej 250 euro-399 euro, nga 10.4% në 2021 në 9.4% në 2022 dhe 8.0% në 2023. Intervali i të hyrave prej 1200 euro-1999 euro pësoi një rënie të lehtë nga 4.2% në 2021 në 5.3% në 2022, por më pas tregoi një rritje në 6.4% në 2023. Përgjithësisht, këto të gjetura sugjerojnë se shumica e ekonomive familjare i ruajtën nivelet e tyre të të hyrave brenda kufijve të caktuar, me një zhvendosje të lehtë drejt klasave më të larta të të hyrave në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme.

Figura 10. Të hyrat pas tatimit të ekonomive familjare: 2021, 2022 dhe 2023



Sa i përket përkatësisë etnike, shumica e shqiptarëve të Kosovës ranë në intervalin prej 400-799 euro për tre vite (42.6%, 43.2% dhe 43.3% për 2023, 2022 dhe 2021 respektivisht). E njëjta gjë është vërejtur për komunitetin serb të Kosovës (34.9% në vitin 2023) dhe komunitete romë, ashkali, egjiptas të Kosovës (47.3% në vitin 2023).

Tabela 10. Të hyrat pas tatimit të ekonomive familjare, sipas përkatësisë etnike për vitin 2023

	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
0 euro - 249 euro	7.6%	3.5%	20.6%
250 euro - 399 euro	9.1%	16.3%	13.7%
400 euro - 799 euro	50.5%	36.4%	47.9%
800 euro - 1199 euro	23.3%	24.1%	13.3%
1200 euro - 1999 euro	7.1%	14.3%	2.6%
2000 euro ose më shumë	2.5%	5.4%	2.0%
Nuk e di/Refuzoj	7.6%	3.5%	20.6%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%
Numri i vëzhgimeve (duke hequr Nuk e di/Refuzon të përgjigjet)	1.012	147	146

Të gjeturat kyçe të këtij seksioni janë si më poshtë:


- ✓ Siç pritej, shumica e ekonomive familjare mbështeteshin te paga/mëditjet si burimi primar i të hyrave;
- ✓ Pagesat institucionale janë raportuar si burim i të hyrave nga 20.7% e të anketuarve dhe remitancat nga 19.1%.
- ✓ Pensionet u shfaqën si forma më e zakonshme e transfereve institucionale, pasuar nga pensionet e lidhura me konfliktin dhe pensionet/kompensimet e invaliditetit.
- ✓ Papunësia ishte e përhapur në mesin e mostrës: 73.2% e totalit të të anketuarve raportuan se kishin individë të papunë brenda ekonomive të anketuara familjare, me një shumicë të konsiderueshme që raportuan papunësi afatgjatë (94%).
- ✓ Mungesa e mundësive të punësimit (46.5%) dhe përgjegjësitë e kujdesit (29.8%) ishin arsytet kyçe të papunësisë.
- ✓ Të hyrat nominale pas tatimit të ekonomive familjare mbetën relativisht të qëndrueshme gjatë viteve, me përqindjen më të lartë që binte brenda intervalit të të hyrave 400-799 euro.

## Shpenzimet e ekonomive familjare

Ky seksion i diskuton të gjeturat në lidhje me përbërjen e shpenzimeve të ekonomive familjare gjatë periudhës 2021-2023. Në përgjithësi, pyetjet këtu fokusohen në të kuptuarit e shpenzimeve për gjëra ushqimore, hipotekë/qira, shërbimet komunale (energji elektrike, gaz, ujë), transporti (derivate, pagesat e makinave, transporti publik), argëtim (shërbimet e transmetimit, ngrënia jashtë, aktivitetet e kohës së lirë), pajisjet elektronike (telefonat e mençur, kompjuterët, pajisjet e tjera elektronike), mundësitë e edukimit dhe/ose trajnimit, dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor (vizita te mjeku, mjekimi, kujdesi shëndetësor).

Të gjeturat e anketës tregojnë se për gjërat ushqimore ka pasur rritje të shpenzimeve nga viti në vit. Teksa në vitin 2021 38.8% e ekonomive familjare shpenzonin 200 ose më shumë euro për gjëra ushqimore, përqindja u rrit në 47.8% në vitin 2022 dhe deri në 59.5% në 2023. Duke qenë se preferencat e konsumit nuk ndryshojnë ndjeshëm në një periudhë kaq të shkurtër kohore dhe fakti që pagat<sup>23</sup> (përfshirë pagën minimale) nuk u rritën ndjeshëm, rritja mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së çmimeve gjatë periudhës së vëzhguar - veçanërisht në vitin 2023. Anasjelltas, përqindja e ekonomive familjare me shpenzime nën 200 euro u zvogëlua me kalimin e kohës (Figura më poshtë).

Figura 11. Shpenzimet mesatare mujore për gjëra ushqimore: Trendet nga viti 2021 deri në 2023



Modelet e shpenzimeve nëpër etni të ndryshme nxjerrin në pah njohuri interesante. Në mesin e ekonomive familjare shqiptare të Kosovës, një përqindje më e madhe shpenzon në nivelet e larta, veçanërisht për ushqime. Në vitin 2021, 39.4% e ekonomive familjare shqiptare të Kosovës kanë raportuar se kanë shpenzuar 200 euro ose më shumë për ushqime. Kjo përqindje u rrit në 48.9% në vitin 2022, dhe u rrit më tej në 60.2% në vitin 2023. Edhe për komunitetin serb të Kosovës ka pasur rritje të dukshme në përqindjen e ekonomive familjare që shpenzojnë 200 euro ose më

<sup>23</sup> Sipas raportit të fundit të pagave për Kosovën (ASK, 2023), në vitin 2021 paga mesatare neto në Kosovë ishte 432 euro dhe 446 euro në vitin 2022 (një rritje për 3.2%): <https://ask.rks-gov.net/media/7536/niveli-i-pagave-ne-kosove-2022.pdf>

shumë për ushqime. Në vitin 2021, vlera ishte 30.4%, e cila u rrit në 34.1% në 2022, dhe u rrit ndjeshëm në 52% në 2023. Në anën tjetër, trendet e shpenzimeve për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës mbetën konsistente në kategorinë 150-199 euro për ushqime. Në vitin 2021, 13.4% e ekonomive familjare raportuan shpenzime brenda këtij intervali dhe kjo shifër u rrit pak në 16% si në 2022 ashtu edhe në 2023.

*Tabela 11. Shpenzimet mesatare mujore për gjëra ushqimore, sipas përkatësisë etnike: Trendet nga viti 2021 deri në 2023*

	2021		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës, Egjiptas të Kosovës
Më pak se 50 euro	0.4%	1.3%	22.9%
50 - 99 euro	11.1%	29.0%	23.4%
100 - 149 euro	28.0%	19.5%	21.1%
150 - 199 euro	21.3%	19.7%	13.4%
200 ose më shumë euro	39.4%	30.4%	17.8%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	0.0%	0.0%	23.6%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/refuzon të përgjigjet)	1,166	140	150

	2022		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës, Egjiptas të Kosovës
Më pak se 50 euro	0.4%	0.6%	21%
50 - 99 euro	7.3%	27.6%	18%
100 - 149 euro	21.6%	18.3%	20%
150 - 199 euro	21.7%	19.3%	16%
200 ose më shumë euro	48.9%	34.1%	24%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	0.1%	0.0%	1%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/refuzon të përgjigjet)	1,176	143	149

	2023		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës, Egjiptas të Kosovës




		Kosovës	
Më pak se 50 euro	0.2%	0.0%	5.2%
50 - 99 euro	4.2%	11.6%	26.4%
100 - 149 euro	17.6%	25.1%	17.2%
150 - 199 euro	17.8%	10.6%	13.1%
200 ose më shumë euro	60.2%	52.0%	37.3%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	0.1%	0.7%	0.7%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/Refuzon të përgjigjet	1,176	143	150

Për sa i përket shpenzimeve mesatare mujore për qira ose kredi hipotekare, mbi 90% e ekonomive familjare nuk kanë shpenzime të tilla dhe përqindja është rritur lehtë me kalimin e kohës. Kjo përkon me faktin se shumica e banorëve të Kosovës jetojnë në objektet e tyre.

Krahasimi i të dhënave nga viti 2021 deri në vitin 2023 për shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale zbulon trende dhe zhvendosje interesante në modelet e shpenzimeve të ekonomive familjare. Ka rritje të përqindjes së ekonomive familjare me konsum mesatar mujor për shërbimet komunale mbi 50 euro në muaj, ndërsa ka rënie të përqindjes së ekonomive familjare që shpenzojnë nën 50 euro. Ky ndryshim e pasqyron ndryshimin e çmimeve të energjisë në vitet 2022 dhe 2023, të cilat llogariten si pjesa më e madhe e kostove të shërbimeve.

Figura 12. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale: Trendet nga viti 2021 deri në 2023



Modele të ngjashme ndër vite vërehen për të gjitha etnitë: një rënie e përqindjes së ekonomive familjare që shpenzojnë më pak se 50 euro dhe një rritje e përqindjes që shpenzojnë 50 ose më shumë euro në muaj.

Tabela 12. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale, sipas përkatësisë etnike:  
Trendet nga viti 2021 deri në 2023

	2021		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Më pak se 50 euro	43.5%	47.0%	40.7%
50 - 99 euro	40.7%	21.3%	41.2%
100 - 149 euro	10.2%	24.7%	11.6%
150 - 199 euro	2.2%	4.3%	0.8%
200 ose më shumë euro	1.4%	0.0%	2.1%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	2.1%	2.7%	3.5%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/Refuzon të përgjigjet	1,188	144	142

	2022		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Më pak se 50 euro	34.5%	33.5%	35.8%
50 - 99 euro	46.0%	35.0%	44.7%
100 - 149 euro	15.1%	25.8%	15.2%
150 - 199 euro	2.3%	4.9%	0.8%
200 ose më shumë euro	1.6%	0.0%	2.1%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	0.7%	0.7%	1.4%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/Refuzon të përgjigjet	1,188	145	142

	2023		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Më pak se 50 euro	26.6%	19.6%	19.4%
50 - 99 euro	47.3%	41.6%	53.0%
100 - 149 euro	20.3%	27.9%	23.2%
150 - 199 euro	3.2%	7.6%	2.2%
200 ose më shumë euro	2.2%	0.0%	0.8%

Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	0.4%	3.3%	1.4%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/Refuzon të përgjigjet	1,192	150	145

Për sa i përket zbërthimit sipas vendbanimit, tabela e mëposhtme i rendit shpenzimet për shërbime komunale nga viti 2021 deri në vitin 2023. Vërehen trende të ngjashme, ku përqindja e familjeve që shpenzojnë më pak se 50 euro zvogëlohet me kalimin e viteve.


*Tabela 13. Shpenzimet mesatare mujore për shërbimet komunale, sipas vendbanimit: Trendet nga viti 2021 deri në 2023*

	Urban 2021	Rural 2021	Urban 2022	Rural 2022	Urban 2023	Rural 2023
Më pak se 50 euro	50.2%	32.0%	39.6%	25.7%	28.9%	20.3%
50 - 99 euro	36.4%	45.2%	44.3%	47.6%	<b>49.8%</b>	<b>44.8%</b>
100 - 149 euro	9.1%	14.4%	13.1%	19.5%	17.5%	25.7%
150 - 199 euro	1.4%	3.6%	1.5%	3.8%	2.4%	5.1%
200 ose më shumë euro	0.9%	2.0%	0.6%	2.9%	0.9%	3.7%
Nuk kemi pasur shpenzime të tilla (N/A)	2.0%	2.7%	0.8%	0.5%	0.5%	0.3%
Gjithsej numri i vëzhgimeve pas heqjes së ND/Refuzon të përgjigjet	610	867	610	854	611	874

Analiza e të dhënave nga viti 2021 deri në vitin 2023 në lidhje me shpenzimet mesatare mujore për transport zbulon se ka një rënie të vazhdueshme të përqindjes së ekonomive familjare që shpenzojnë më pak se 30 euro për transport gjatë periudhës trevjeçare. Në vitin 2021, 27% e ekonomive familjare ishin në këtë interval të shpenzimeve, i cili ra në 20.6% në vitin 2022 dhe më tej u ul në 17.1% në 2023. Anasjelltas, ka një trend në rritje të përqindjes së ekonomive familjare në interval më të lartë të shpenzimeve. Përqindja e ekonomive familjare në intervalin 30-79 euro mbeti relativisht e qëndrueshme nga viti 2021 në 2022, por u ul në 33.5% në 2023. Ndërkohë, përqindja e ekonomive familjare në intervalin 80-129 euro u rrit nga 17.7% në 2021 në 22.7% në


2022 dhe më tej në 25% në 2023. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e ekonomive familjare në intervalin 130-179 euro dhe 180 euro ose më shumë, tregon rritje të qëndrueshme gjatë viteve. Ky konstatim është gjithashtu në përputhje me rritjen e çmimeve të derivateve në vitet 2022 dhe 2023.

Figura 13. Shpenzimet mesatare mujore për transport: Trendet nga viti 2021 deri në 2023




Për sa i përket shpenzimeve për argëtim, të gjeturat e anketës sugjerojnë se ka një përqindje në rritje të shpenzimeve të ekonomive familjare në intervalet më të larta nga viti 2021 deri në 2023. Për më tepër, edhe pse në vitin 2021 42.9% e ekonomive familjare pretendonin se kishin shpenzuar më pak se 30 euro për argëtim, kjo përqindje ra në 37.4% në vitin 2023. Në mënyrë të ngjashme, teksa në vitin 2021, 13.3% pretendonin se shpenzonin midis 80-129 euro për argëtim, kjo përqindje u rrit në 18.6% në 2023.

Figura 14. Shpenzimet mesatare mujore për argëtim: Trendet nga viti 2021 deri në 2023




Në lidhje me trendet e shpenzimeve për pajisje elektronike, përqindja e ekonomive familjare që nuk kanë blerë pajisje të tilla është rritur nga 35.7% në 2021 në 41% në 2023, çka mund të jetë për shkak të rritjes së çmimeve për nevoja të tjera bazë (siç është raportuar më lart për gjërat ushqimore, kostot e shërbimeve komunale). Përqindja e ekonomive familjare është rritur lehtë për shpenzimet 50-99 euro dhe 200 euro ose më shumë, ndërsa për klasat e tjera të shpenzimeve pjesa e ekonomive familjare ka rënë.

Figura 15. Shpenzimet mesatare mujore për pajisje elektronike: Trendet nga viti 2021 deri në 2023




Për sa u përket shpenzimeve për mundësi arsimit apo trajnimit, pjesa e ekonomive familjare pa shpenzime për arsim është rritur lehtë me kalimin e kohës, nga 34% në 2021, në 34.4% në 2022 dhe deri në 35.1% në 2023. Pothuajse në të gjitha klasat e shpenzimeve, përqindja e ekonomive familjare u rrit, si rezultat i rritjes së çmimeve në tre vitet e njëpasnjëshme.

Figura 16. Shpenzimet mesatare mujore për arsim ose trajnim: Trendet nga viti 2021 deri në 2023



Në fund, për sa i përket shpenzimeve të ekonomive familjare për shërbime shëndetësore, të gjeturat tregojnë një rritje të përqindjes së shpenzimeve të ekonomive familjare në nivelet më të larta të shpenzimeve gjatë periudhës së vëzhguar. Ka një rritje graduale të përqindjes së ekonomive familjare në intervalet më të larta të shpenzimeve. Përqindja e ekonomive familjare që shpenzojnë 180 euro ose më shumë për shërbimet e kujdesit shëndetësor tregon një rritje të vazhdueshme, duke u rritur nga 4.2% në 2021 në 5% në 2022 dhe më tej në 6.7% në 2023. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e ekonomive familjare në intervalin e shpenzimeve prej 80 deri në 129 euro, u rrit nga 12.5% në 2021 në 16.1% në 2022 dhe më tej në 16.7% në 2023. Një përqindje në rënie e ekonomive familjare është vërejtur për shpenzimet më pak se 30 euro, nga 43.5% në 2021 në 35.9% në 2023. Nga ana tjetër, ka një rritje graduale të përqindjes së ekonomive familjare në interval më të lartë të shpenzimeve.

Figura 17. Shpenzimet mesatare mujore për shërbime shëndetësore: Trendet nga viti 2021 deri në 2023



Analiza e modeleve të shpenzimeve nga viti 2021 deri në vitin 2023 zbulon disa të gjetura kyçe. Në kategori të ndryshme të shpenzimeve ka një zhvendosje drejt niveleve më të larta të shpenzimeve. Përqindja e ekonomive familjare me shpenzime më të ulëta në përgjithësi ka rënë gjatë viteve. Ky trend është i dukshëm në kategoritë e sendeve ushqimore, shërbimeve komunale, transportit, pajisjeve elektronike, mundësive të arsimit ose trajnimit dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Edhe pse nuk është e mundur të jepet një konkluzion përfundimtar në këtë moment në lidhje me ndikimin negativ të çmimeve më të larta në cilësinë e përgjithshme të jetës së ekonomive familjare, ka disa vëzhgime që mund të nxirren. Për shembull, paga mesatare individuale brenda mostrës është rritur për 12.4% nga viti 2021 në 2023. Megjithatë, ekonomitë familjare që shpenzojnë më shumë se 200 euro për ushqime kanë përjetuar një rritje prej 20.7% në shpenzimet e tyre ushqimore gjatë së njëjtës kohë. Meqenëse gjërat ushqimore konsiderohen mallra esenciale me kërkesa jo-elastike, kjo sugjeron që pagat nominale nuk po rriten me një normë të krahasueshme me nivelin e shpenzimeve për plotësimin e nevojave. Kjo pabarazi mes të hyrave dhe shpenzimeve ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së ekonomive familjare nëpërmjet uljes së fuqisë blerëse të tyre.

Perceptimi i ekonomive familjare për mënyrën se si ndikon rritja e inflacionit në zgjedhjet dhe cilësinë e jetës së tyre

Seksionet vijuese synojnë t'i eksplorojnë mënyrat në të cilat inflacioni ka ndikuar në vendimmarrjen ekonomike, të tilla si ndryshimet në zakonet e konsumit, nivelet e borxhit, varësinë nga ndihmat sociale dhe remitancat, dhe efektet në mirëqenien sociale dhe mendore. Gjithashtu, diskutohen propozimet e të anketuarve për masat e nevojshme institucionale për adresimin e çështjes së inflacionit.

#### *Modelet dhe ndryshimet e të hyrave dhe shpenzimeve*

Së pari, pothuajse të gjithë të anketuarit (99.5%) pohuan se e kanë vërejtur se çmimi i gjërave që ata blejnë është rritur vitin e kaluar. Një shumicë e dukshme, 91.4%, shprehën shqetësime dhe brengë për ndikimin e mundshëm negativ të rritjes së çmimeve në situatën financiare të ekonomive të tyre familjare. Për më tepër, 69.2% raportuan se duhej që t'i përshtatnin zakonet e tyre të shpenzimeve ose buxhetin në përgjigje ndaj çmimeve më të larta vitin e kaluar. Kjo përshtatje tregon një pasojë të prekshme të rritjes së çmimeve, pasi individët janë të detyruar të bëjnë ndryshime në modelet e tyre të konsumit për t'iu përshtatur rritjes së kostos së mallrave dhe shërbimeve. Përgjithësisht, niveli i lartë i shqetësimit dhe nevoja për përshtatje në zakonet e shpenzimeve demonstrojnë cenueshmërinë e ekonomive familjare ndaj presioneve inflacioniste.

Figura 18. Perceptimi i përgjithshëm mbi inflacionin gjatë vitit të kaluar







Figura 19. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve



Sipas përkatësisë etnike, individët romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës kishin më shumë gjasa të vërenin ndryshime, të shqetësoheshin dhe t'i përshtatnin zakonet e tyre të shpenzimeve: të gjithë romët, ashkallitë dhe egjiptasit e Kosovës krahasuar me 99.6% të shqiptarëve të Kosovës, 96.5% të serbëve të Kosovës, kanë vërejtur një rritje të konsiderueshme të çmimeve të gjërave që i kanë blerë vitin e kaluar. Për më tepër, 78.8% e romëve, ashkallive dhe egjiptasve të Kosovës, krahasuar me 61.4% të shqiptarëve të Kosovës dhe vetëm 37.9% të serbëve të Kosovës, janë shprehur shumë të shqetësuar për rritjen e çmimeve që ndikojnë negativisht në gjendjen financiare të ekonomive të tyre familjare. Në fund, 88.1% e romëve, ashkallive dhe egjiptasve të Kosovës, krahasuar me 70% të shqiptarëve të Kosovës dhe 63.2% të serbëve të Kosovës, raportuan se u duhet t'i ndryshojnë zakonet e shpenzimeve ose buxhetin e ekonomisë së tyre familjare për shkak të çmimeve më të larta.


Tabela 14. Perceptimi i përgjithshëm mbi inflacionin gjatë vitit të kaluar, sipas përkatësisë etnike

A keni vënë re se çmimet e gjërave që bleni janë rritur vitin e kaluar?	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Po	99.6%	96.5%	100.0%
Jo	0.4%	3.5%	0.0%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%
Gjithsej numri i vëzhgimeve	1,200	150	150

Sa ju shqetëson rritja e çmimeve që ndikon negativisht në situatën financiare të ekonomisë suaj familjare?	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Shumë i/e shqetësuar	61.4%	37.9%	78.8%
Deri diku i/e shqetësuar	30.9%	38.7%	18.0%
Jo shumë i/e shqetësuar	6.4%	22.0%	3.2%
Aspak i/e shqetësuar	1.3%	1.3%	0.0%
Gjithsej numri i vëzhgimeve	<b>1,200</b>	<b>150</b>	<b>150</b>


Sipas gjinisë, nuk kishte ndryshime të rëndësishme në lidhje me vërejtjen e ndryshimeve të çmimeve, por femrat ishin më të shqetësuara për rritjen e çmimeve dhe një përqindje më e lartë raportoi se duhej të bënin përshtatje në shpenzime.

Figura 20. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve, sipas gjinisë




Rezultatet janë të ngjashme kur zërthehen sipas llojit të vendbanimit. Të dyja rajonet tregojnë shkallë të shtuar të shqetësimit.

Figura 21. Niveli i shqetësimit për rritjen e çmimeve, sipas llojit të vendbanimit




Më pas, të anketuarit u pyetën se si ka ndikuar rritja e kostos së jetesës në zakonet e shpenzimeve të ekonomive të tyre familjare. 44.1% e të anketuarve raportuan se kanë blerë më pak produkte dhe kanë shpenzuar më shumë para, **çka tregon një ulje të fuqisë blerëse**. Anasjelltas, 7.0% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më pak para, duke sugjeruar një rënie si në konsum ashtu edhe në shpenzime. Po ashtu, 3.5% raportuan se e blejnë të njëjtin numër produktesh, por shpenzojnë më pak para, çka tregon nevojën për përshtatje të buxhetit. Nga ana tjetër, **42.1% raportuan se e kanë blerë të njëjtin numër të produkteve, por kanë shpenzuar më shumë para, çka tregon rritje të çmimeve**. Vetëm 3.0% raportuan se blejnë më shumë produkte dhe shpenzojnë më shumë para, duke sugjeruar rritje të konsumit.

Figura 22. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës




Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës kanë demonstruar një ndikim më të theksuar, me 62.1% që kanë raportuar se kanë blerë më pak produkte dhe kanë shpenzuar më shumë para (krahasuar me 43.7% në mesin e shqiptarëve të Kosovës dhe 42.2% për serbët e Kosovës).

Figura 23. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës, sipas përkatësisë etnike



Të dhënat e anketës e nxjerrin në pah ndikimin e kundërt të inflacionit tek ekonomitë familjare që jetojnë në zonat rurale dhe urbane. Është e evidente se ekonomitë familjare rurale po përballen me një efekt më të theksuar, ku 49.7% e të anketuarve deklarojnë se blejnë më pak produkte, por shpenzojnë më shumë para. Në të kundërt, ekonomitë familjare urbane janë relativisht më pak të prekura, ku 34.5% e tyre raportojnë ndryshime të ngjashme në modelet e tyre të shpenzimeve.

Figura 24. Inflacioni dhe ndikimet e tij në koston e jetesës, sipas llojit të vendbanimit



Të anketuarit u pyetën gjithashtu për produktet specifike që konsumojnë dhe se si ka ndikuar rritja e çmimeve në sjelljen e konsumatorëve në lidhje me kategoritë e ndryshme të shpenzimeve nga viti 2021 deri në vitin 2023. Pikat kyçe janë:

1. **Ushqimet:** Shumica e të anketuarve (50%) kanë raportuar se kanë blerë të njëjtën sasi të ushqimeve, por kanë shpenzuar më shumë para, **çka tregon rritje të çmimeve dhe rritje të shpenzimeve**. Për më tepër, 34.4% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më shumë para, duke sugjeruar një ulje të fuqisë blerëse.
2. **Qiratë ose kreditë hipotekare:** Një përqindje e konsiderueshme (76%) treguan "Nuk aplikohet" për këtë kategori, duke sugjeruar se pyetja nuk vlente për situatën e tyre, kryesisht sepse ata ndoshta janë pronarë të shtëpisë ku jetojnë. Ndër përgjigjet e aplikueshme (n=360 për këtë pyetje), 11.1% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më pak para për qira ose kredi hipotekare, ndërsa 8.7% raportuan se e blejnë të njëjtin numër të produkteve, por shpenzojnë më shumë para.

3. **Shërbimet komunale:** Gjithsej 45% raportuan se e konsumonin të njëjtën sasi të shërbimeve, por shpenzonin më shumë para, çka tregon rritje të kostove. Ndërkohë, 32% raportuan se kanë blerë më pak produkte dhe kanë shpenzuar më shumë para, duke reflektuar rënie të konsumit, por shpenzime më të larta.
4. **Argëtimi:** Gjithsej 38% raportuan se blenë të njëjtin numër të produkteve/shërbimeve të argëtimit, por shpenzuan më shumë para, çka tregon rritje të çmimeve. Për më tepër, 37% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më shumë para, duke sugjeruar një reduktim të shpenzimeve për argëtim.
5. **Pajisjet elektronike:** Pothuajse një e treta (30%) raportuan se blenë të njëjtin numër të pajisjeve elektronike, por shpenzuan më shumë para, çka tregon rritje të çmimeve. Ndërkohë, 31% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më shumë para, çka sugjeron ulje të konsumit në këtë kategori.
6. **Arsimi:** Rreth një e treta (32%) kanë raportuar se e kanë blerë të njëjtin numër të produkteve/shërbimeve arsimore, por kanë shpenzuar më shumë para, çka tregon kosto më të larta. Për më tepër, 23% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më shumë para për arsim.
7. **Kujdesi shëndetësor:** Gjysma e të anketuarve (50%) kanë raportuar se e kanë blerë të njëjtin numër të produkteve shëndetësore, por kanë shpenzuar më shumë para, çka tregon rritjen e kostove të kujdesit shëndetësor. Ndërkohë, 34% raportuan se blejnë më pak produkte dhe shpenzojnë më shumë para, duke reflektuar një ulje të konsumit të kujdesit shëndetësor, por shpenzime më të larta.

Tabela 15. Modelet e shpenzimeve sipas kategorive

	Ushqime	Qira ose kredi hipotekare	Shërbimet komunale	Argëtim	Pajisje elektronike	Arsim	Shëndet
Blejmë më pak, shpenzojmë më shumë	34%	11% (48% e vëzhgimeve relevante)	32%	37%	31%	23%	34%
Blejmë më pak, shpenzojmë më pak	6%	1% (5% e vëzhgimeve relevante)	10%	7%	8%	6%	6%
Blejmë njësoj,	3%	1% (5% e vëzhgimeve	6%	7%	6%	4%	3%

shpenzojmë më pak		e relevante)					
Blejmë njësoj, shpenzojmë më shumë	50%	9% (37% e vëzhgimeve e relevante)	45%	38%	30%	32%	50%
Blejmë më shumë, shpenzojmë më shumë	4%	1% (4% e vëzhgimeve e relevante)	4%	5%	4%	5%	4%
Blejmë më shumë, shpenzojmë më pak	0%	0% (1% e vëzhgimeve e relevante)	0%	0%	0%	0%	0%
Nuk aplikohet	1%	76%	2%	5%	21%	29%	1%
Numri i vëzhgimeve (janë hequr Nuk di/Refuzon të përgjigjet)	1,494	1,479 (360 pohuan se kishin shpenzime qiraje/kredia hipotekare në këtë pyetje)	1,434	1,443	1,448	1,452	1,465

Për sa i përket rritjes së çmimeve dhe shpenzimeve nëpër kategori, veçanërisht gjatë periudhës 2021-2023, pavarësisht nga modelet e tyre të konsumit, të gjeturat kyçe janë si më poshtë:

1. **Ushqimet:** Shumica e të anketuarve (84.4%) raportuan se çmimet e produkteve ushqimore ishin rritur shumë gjatë kësaj periudhe , **duke treguar një ndikim të rëndësishëm të inflacionit në kostot e ushqimit.** Një përqindje më e vogël (15.0%) raportoi një rritje të lehtë të çmimeve të ushqimeve. Edhe për sa i përket shpenzimeve, **pjesa dërrmuese (92.1%) raportuan një rritje të madhe të shpenzimeve për gjëra ushqimore, duke e reflektuar ndikimin e rritjes së çmimeve të ushqimeve.** Një përqindje më e vogël (6.8%) raportuan një rritje të lehtë.
2. **Qiratë ose kreditë hipotekare:** Pak mbi 40% (41.9%) e të gjithë mostrës raportuan se çmimet e qirasë ose kredisë hipotekare ishin rritur shumë, duke sugjeruar rritje të kostove të banesave/kostove të qirasë. Gjithashtu, 29.0% raportuan një rritje të lehtë të çmimeve.
3. **Shërbimet komunale:** Gati gjysma e të anketuarve (49.5%) treguan një **rritje të madhe të çmimeve të shërbimeve, duke treguar kosto më të larta për shërbimet esenciale.** Një përqindje më e vogël (12.2%) raportoi se çmimet qëndruan të njëjta. Për sa u përket shpenzimeve, më shumë se gjysma (56.7%) raportuan një rritje të madhe të shpenzimeve për shërbimet

komunale, duke e vënë në pah rritjen e kostove të shërbimeve esenciale. Ndërkohë, 27.3% raportuan një rritje të lehtë.

4. **Argëtimi:** Një pjesë e madhe e të anketuarve (60.6%) raportuan një rritje të madhe të çmimeve për shërbimet argëtuuese, çka tregon kosto më të larta për aktivitetet e kohës së lirë. Ndërkohë, 33.8% raportuan rritje të lehtë të çmimeve. Sa u përket shpenzimeve, dy të tretat (66.8%) raportuan një rritje të madhe të shpenzimeve për argëtim, çka tregon kosto më të larta për aktivitetet e kohës së lirë. Gjithashtu, 20.5% raportuan një rritje të lehtë.
5. **Pajisjet elektronike:** Më shumë se gjysma e të anketuarve (52.1%) raportuan një rritje të madhe të çmimeve për pajisjet elektronike, duke sugjeruar rritje të kostove në këtë kategori. Gjithashtu, 36.2% raportuan një rritje të lehtë të çmimeve. Sa u përket shpenzimeve, gjysma e të anketuarve (51.1%) raportuan një rritje të madhe të shpenzimeve për pajisje elektronike, duke sugjeruar rritje të kostove në këtë kategori. Gjithashtu, 25.8% raportuan një rritje të lehtë.
6. **Arsimi:** Gjithsej 45.6% raportuan një rritje të madhe të çmimeve të arsimit, duke treguar kosto më të larta për produktet/shërbimet arsimore. Ndërkohë, 31.2% raportuan rritje të lehtë të çmimeve. Për sa u përket shpenzimeve, 41.4% raportuan rritje të madhe të shpenzimeve për shërbimet arsimore, duke treguar kosto më të larta për qëllimet arsimore. Ndërkohë, 27.1% raportuan një rritje të lehtë.
7. **Kujdesi shëndetësor:** Gati 60% (59.2%) raportuan një rritje të madhe të çmimeve të kujdesit shëndetësor, duke sugjeruar kosto më të larta për shërbimet dhe trajtimet mjekësore. Ndërkohë, 31.4% raportuan rritje të lehtë të çmimeve. Sa u përket shpenzimeve, dy të tretat (66.5%) raportuan një rritje të madhe të shpenzimeve për shërbimet shëndetësore, duke reflektuar kosto më të larta për trajtime dhe shërbime mjekësore. Gjithashtu, 22.6% raportuan një rritje të lehtë.

Këto të gjetura nxjerrin në pah pajtimin e gjerë midis të anketuarve se çmimet janë rritur ndjeshëm në të gjitha kategoritë, duke përfshirë gjërat ushqimore, banimin, shërbimet komunale, argëtimin, pajisjet elektronike, arsimin dhe kujdesin shëndetësor. Kjo është në përputhje me statistikën zyrtare të çmimeve të raportuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën e mbuluar.<sup>24</sup>

---

<sup>24</sup> <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/cmimet>



Figura 25. Rritjet e çmimeve sipas kategorive






Figura 26. Shpenzimet sipas kategorive



Të gjeturat kyçe në lidhje me **ndikimin e inflacionit në aftësinë** për të blerë/për qasje në mallra dhe shërbime të ndryshme, janë si më poshtë:

1. **Ushqimet:** Gjysma (47.3%) raportuan se inflacioni ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e tyre për të blerë gjëra ushqimore, duke e theksuar rritjen e kostos së artikujve ushqimorë esencialë. Gjithashtu, 27.9% deklaruan se inflacioni ka ndikuar deri diku në aftësinë e tyre në këtë drejtim.
2. **Qiratë/kreditë hipotekare:** Shumica (86.6%) përmendën se asnjëherë nuk kanë pasur shpenzime të tilla ose nuk shpenzojnë për qira/kredi hipotekare. Megjithatë, 4.6% raportuan një nivel ndikimi. Nga mostra relevante që raportuan se kishin shpenzime për qira/kredi hipotekare, 24% raportuan se inflacioni ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e tyre për të blerë mallra dhe shërbime.
3. **Shërbimet komunale:** Një përqindje e dukshme (39.8%) raportuan se inflacioni ka ndikuar deri diku në aftësinë e tyre për t'i paguar shërbimet komunale.
4. **Shërbimet e argëtimit:** Nga e gjithë mostra në total, 37.5% deklaruan se inflacioni ka ndikuar deri diku dhe 32.9% se aftësia e tyre për të paguar për argëtim është ndikuar ndjeshëm.
5. **Pajisjet elektronike:** Një e treta (33.2%) deklaruan se inflacioni ka ndikuar deri diku dhe 27.2% raportuan një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tyre për të blerë pajisje elektronike, duke sugjeruar çmime më të larta në këtë kategori.
6. **Shërbimet arsimore:** Nga gjithsej të anketuarit, 24,2% raportuan ndikim deri diku dhe 16,9% raportuan ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tyre për t'i përballuar shërbimet arsimore.
7. **Shërbimet shëndetësore:** Nga të gjitha vëzhgimet, 25.3% raportuan një ndikim të rëndësishëm, duke e theksuar rritjen e kostove të trajtimeve dhe shërbimeve mjekësore dhe pak më shumë se një e treta (36.2%) deklaruan se inflacioni nuk ka ndikuar në aftësinë e tyre për t'i përballuar shërbimet e kujdesit shëndetësor.


Figura 27. Ndikimi i inflacionit në aftësinë e ekonomive familjare për të blerë mallra sipas kategorive (duke hequr ND/refuzon të përgjigjet)



Për sa i përket nivelit të shqetësimit, 91.6% janë shprehur se janë të shqetësuar se çmimet do të vazhdojnë të rriten edhe në të ardhmen, dhe kjo do të ndikojë më tej në cilësinë e jetës së banorëve.


Një shumicë e konsiderueshme (94.1% e romëve, ashkalive dhe egjiptasve të Kosovës, 92.2% e serbëve të Kosovës, 91.7% e shqiptarëve të Kosovës) e shprehin shqetësimin se çmimet do të vazhdojnë të rriten në të ardhmen dhe do të kenë ndikim të mëtejshëm negativ në cilësinë e jetës së tyre.

Figura 28. Niveli i shqetësimit për rritjen e nivelit të çmimeve, sipas përkatësisë etnike



Një pjesë më e madhe e femrave (92.6%) janë të brengosura për rritjen e vazhdueshme të çmimeve në krahasim me meshkujt (90.7%).

Figura 29. Niveli i shqetësimit për rritjen e nivelit të çmimeve, sipas gjinisë



Kur të anketuarit u pyetën se si i perceptojnë çmimet e rritura që kanë ndikuar në aftësinë e tyre për të kursyer, 32.8% perceptojnë se çmimet më të larta kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tyre për të kursyer; 24.6%, deklarojnë se nuk kursejnë fare para: aftësia për të kursyer ishte më e ulët në mesin e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës) dhe për femrat

aftësia për të kursyer ka pak më shumë gjasa të ndikohet (32.1% e meshkujve dhe 33.5% e femrave). Këto të gjetura tregojnë se një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare po përballen me sfida në kursimin e parave për shkak të rritjes së çmimeve, në mënyrë të konsiderueshme ose në një farë mase, ndërsa të tjerat nuk ndikohen ose nuk janë në gjendje të kursejnë pavarësisht ndryshimeve të çmimeve.

Figura 30. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta




Figura 31. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta, sipas përkatësisë etnike





Figura 32. Aftësia për të kursyer para për shkak të çmimeve më të larta, sipas gjinisë



Si përfundim, të gjeturat tregojnë se **inflacioni ka ndryshuar ndjeshëm në zgjedhjet ekonomike dhe ka ndikuar në situatën financiare të individëve**. Shumica e të anketuarve kanë vërejtur rritje të çmimeve dhe e kanë shprehur shqetësimin për ndikimin negativ në financat e tyre. **Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, në përgjigje të çmimeve më të larta, i kanë përshtatur zakonet e shpenzimeve dhe buxhetet**. Ndikimi i inflacionit në modelet e shpenzimeve të ekonomive familjare ndryshonte në kategori të ndryshme. Rritja e çmimeve ka çuar në një ulje të fuqisë blerëse për gjërat ushqimore, shërbimet komunale, shërbimet argëtuese, pajisjet elektronike, arsimin dhe kujdesin shëndetësor. Kostot e qirasë apo kreditë hipotekare u ndikuan më pak në përgjithësi, por ende kishte raporte për rritje të shpenzimeve. Këto të gjetura e nxjerrin në pah cenueshmërinë e ekonomive familjare ndaj presioneve inflacioniste dhe nevojën për masa përshtatëse për ta menaxhuar peisazhin ekonomik në ndryshim. Për më tepër, shumica e të anketuarve e shprehën shqetësimin për rritjen e mëtejshme të çmimeve dhe ndikimin e mundshëm afatgjatë në cilësinë e jetës së tyre. Në fund, shumica besojnë se potenciali i tyre për kursime është penguar për shkak të rritjes së çmimeve.

#### Kufiri i varfërisë dhe të dhënat e mostrës: Krahasimi i të hyrave në mes të viteve 2021 dhe 2023

Bazuar në të dhënat e mbledhura, është bërë një analizë për të kuptuar se sa nga ekonomitë e anketuara familjare kanë rënë në varfëri nga viti 2021 deri në vitin 2023, duke e marrë parasysh pragun e varfërisë prej 1.85 euro në ditë<sup>25</sup>. Është e rëndësishme të theksohet se 374 ekonomi familjare që nuk pranuan t'i shpalosin të hyrat e tyre të sakta mujore për vitet 2023, 2022 dhe 2021, u përjashtuan nga kjo analizë. Prandaj, madhësia përfundimtare e mostrës është 1,126.

<sup>25</sup> BERZH. Diagnostikimi i Vendit për Kosovën: Sfidat dhe mundësitë për investime private 2022; Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019).

Për t'i vlerësuar të hyrat mujore për kokë banori, të hyrat totale të ekonomisë familjare janë pjesëtuar me numrin e individëve që banojnë në ekonomi familjare<sup>26</sup>. Qëllimi i raportit është të kuptojë se sa individë kanë rënë në kufirin e varfërisë prej 1.85 euro/ditë.

Për ta llogaritur inflacionin, variabli i të hyrave nominale është përshtatur duke e përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit të Kosovës për tre pika kohore: maj 2021, maj 2022 dhe maj 2023<sup>27</sup>. Variabli i të hyrave reale mujore që rezulton u konvertua në mesatare ditore dhe çdo vëzhgim u krahasua me pragun e varfërisë. Çdo vëzhgim me vlerë negative, që tregon individë që fitojnë më pak se 1.85 euro në ditë, u mbajt dhe u pjesëtua me mostrën totale për ta përcaktuar përqindjen e individëve që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Kjo analizë është kryer për të trija vitet dhe është llogaritur ndryshimi në përqindje ndërmjet vitit 2023 dhe 2021.

*Tabela 16. Ekonomitë familjare nën pragun e varfërisë*

	2023	2022	2021
Numri i familjeve që jetojnë nën 1.85 euro/ditë	181	199	164
Përqindja e familjeve që jetojnë nën 1.85 euro/ditë	16%	17.6%	14.5%
Nr. i vëzhgimeve dukshëm më të varfra mes viteve 2023 dhe 2021	10%		
Nr. i vëzhgimeve dukshëm më të varfra mes viteve 2022 dhe 2021	21%		
Gjithsej numri i vëzhgimeve	1,126		

Bazuar në këtë analizë, rezultoi se 10% e ekonomive familjare ishin më të varfra mes vitit 2023 dhe 2021. Vlen gjithashtu të theksohet se numri i vëzhgimeve me rënie të konsiderueshme ekonomike në vitin 2023 ishte më i ulët krahasuar me krahasimin në mes të viteve 2022 dhe 2021, ku 21% e vëzhgimeve treguan një rënie të ndjeshme.

### *Borxhi*

U përdor edhe një grup i pyetjeve për ta vlerësuar shkallën e borxhit të ekonomive familjare dhe çdo ndryshim në nivelet e borxhit gjatë tre viteve të fundit. Kjo u bë për ta shqyrtuar korrelacionin midis rritjes së çmimeve dhe niveleve të rritura të borxhit.

Grupi i parë i pyetjeve të parashtruara ishte në lidhje me marrjen e kredive nga individët, përdorimin e kartelave të kreditit dhe vonesat e pagesave për ta luftuar inflacionin. Sa u përket


<sup>26</sup> Pew Research Center. Rregullimi i të hyrave për madhësinë e ekonomisë familjare. Në dispozicion në: <https://www.pewresearch.org/social-trends/2015/12/09/methodology/>

<sup>27</sup> Ekonomia e tregtimit. Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) në Kosovë. Në dispozicion në: <https://tradingeconomics.com/kosovo/consumer-price-index-cpi>

kredive apo linjave të kredisë, **16.1% e të anketuarve kanë raportuar se kanë marrë instrumente të tilla financiare gjatë vitit të kaluar.** Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e mostrës është mbështetur në fondet e marra hua për t'i përmbushur nevojat e tyre financiare. Në mënyrë të ngjashme, 16.3% e të anketuarve deklaruan se duhet të përdorin kartela krediti ose forma të tjera borxhi për t'i mbuluar shpenzimet e ekonomisë familjare. Kjo e **nënvizon mbizotërimin e përdorimit të borxhit si një mjet për t'i menaxhuar çmimet e rritura.**

Për më tepër, konstatimi se 29.0% e të anketuarve raportuan shkurtim të shpenzimeve të tjera ose vonesa në pagesat e faturave, është tregues i vështirësive financiare të përjetuara nga një pjesë e konsiderueshme e mostrës. Përgjithësisht, këto të gjetura demonstrojnë sfidat e mundshme financiare me të cilat përballen individët dhe ekonomitë familjare për shkak të çmimeve më të larta ose rritjes së shpenzimeve.

Figura 33. Përdorimi i kartelave të kreditit dhe linjave të kredisë për t'i mbuluar shpenzimet



Në mesin e të anketuarve shqiptarë të Kosovës, 13.8% kanë raportuar se kanë marrë kredi apo linja kreditore gjatë vitit të kaluar për t'i mbuluar shpenzimet e rritura të jetesës, ndërsa 15.4% është dashur të përdorin kartela krediti ose forma të tjera të borxhit për t'i mbuluar shpenzimet e ekonomisë familjare. Po ashtu, 28.1% prej shqiptarëve të Kosovës iu është dashur t'i shkurtojnë shpenzimet e tjera ose t'i vonojnë pagesat e faturave në mënyrë që t'i bëjnë pagesat e borxhit në lidhje me shpenzimet e ekonomisë familjare.



Në mesin e serbëve të Kosovës, masave financiare iu drejtuan një përqindje më e lartë. 40.8% kanë marrë kredi ose linja krediti, 29.5% kanë përdorur kartela krediti ose forma të tjera borxhi dhe 46.7% u është dashur t'i shkurtajnë shpenzimet ose t'i vonojnë pagesat e faturave.

Për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, 35.1% kanë marrë kredi ose linja krediti, 35.2% kanë përdorur kartela krediti ose forma të tjera të borxhit, dhe një pjesë e konsiderueshme prej 55.3% u është dashur t'i shkurtajnë shpenzimet ose t'i vonojnë pagesat e faturave.

Këto të gjetura sugjerojnë se si meshkujt ashtu edhe femrat kanë përdorur masa financiare për ta përballuar ndikimin e inflacionit në koston e tyre të jetesës. Megjithatë, përqindja e meshkujve që merrnin hua ose kredi ishte pak më e lartë në krahasim me femrat. Për më tepër, një përqindje më e lartë e femrave raportuan se i kishin shkurtuar shpenzimet ose i vonuan pagesat për t'i menaxhuar detyrimet e tyre të borxhit.

*Tabela 17. Përdorimi i kartelave të kreditit dhe linjave të kredisë për t'i mbuluar shpenzimet, sipas përkatësisë etnike*

Marrja e një kredie për ta luftuar inflacionin	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Po	13.8%	40.8%	35.1%
Jo	86.2%	59.2%	64.9%
<b>Gjithsej n</b>	<b>1,200</b>	<b>150</b>	<b>150</b>
Përdorimi i kartelës së kreditit për ta luftuar inflacionin	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Po	15.4%	29.5%	35.2%
Jo	84.6%	70.5%	64.8%
<b>Gjithsej n</b>	<b>1,200</b>	<b>150</b>	<b>150</b>
Ndryshimi i zakoneve të shpenzimit shkaku i inflacionit	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë të Kosovës, Ashkali të Kosovës Egjiptas të Kosovës
Po	28.1%	46.7%	55.3%
Jo	71.9%	53.3%	44.7%
<b>Gjithsej numri i vëzhgimeve</b>	<b>1,200</b>	<b>150</b>	<b>150</b>

Më pas, u shtruan një sërë pyetjesh në lidhje me nivelin e shqetësimit të individëve në lidhje me aftësinë e tyre për ta shlyer borxhin dhe nëse nivelet më të larta të çmimeve kanë çuar në pamundësinë e tyre për ta shlyer borxhin.

Lidhur me shqetësimet për borxhin e akumuluar për shkak të rritjes së koston të jetesës, të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë shprehur nivele të ndryshme

shqetësimi. Konkretisht, 19.6% raportuan se ishin shumë të shqetësuar, ndërsa 23.2% deklaruan se ishin deri diku të shqetësuar.

Të gjeturat tregojnë se rritja e kostos së jetesës ka pasur ndikim në aftësinë e të anketuarve për t'i shlyer borxhet ekzistues: 14.7% deklaruan se ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e tyre, ndërsa 22.1% raportuan se ka ndikuar deri diku në aftësinë për ta shlyer borxhin ekzistues.

Për sa u përket shqetësimeve për aftësinë për ta shlyer borxhin e akumuluar, të dhënat tregojnë modele të ngjashme, me 13.8% që shprehen shumë të shqetësuar dhe 20.1% deri diku të shqetësuar.

*Tabela 18. Niveli i shqetësimit për borxhin*


Sa i/e shqetësuar jeni për borxhin e akumuluar të ekonomisë suaj familjare?		Si ka ndikuar rritja e kostos së jetesës në aftësinë tuaj për ta shlyer borxhin?		A jeni të shqetësuar se ekonomia juaj familjare nuk do të jetë në gjendje ta shlyejë borxhin që keni grumbulluar?	
Shumë i/e shqetësuar	19.6%	Ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë time për ta shlyer borxhin ekzistues	14.7%	Shumë i/e shqetësuar	13.8%
Deri diku i/e shqetësuar	23.2%	Ka ndikuar deri diku në aftësinë time për ta shlyer borxhin ekzistues	22.1%	Deri diku i/e shqetësuar	20.1%
Jo shumë i/e shqetësuar	6.3%	Nuk ka ndikuar në aftësinë time për ta shlyer borxhin ekzistues	5.0%	Jo shumë i/e shqetësuar	6.0%
Aspak i/e shqetësuar	3.5%	Nuk ia vlen/nuk kemi borxh	58.2%	Aspak i/e shqetësuar	2.9%
NP	47.4%			NP	56.3%
Gjithsej n	1,500		1,500		1,500

Në përmbledhje, të gjeturat e kësaj pjese japin dëshmi bindëse se rritja e inflacionit ka çuar në rritjen e borxhit të ekonomive familjare. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve u mbështetën në kredi, linja krediti dhe kartela krediti për t'i përmbushur nevojat e tyre financiare, duke e treguar mbizotërimin e përdorimit të borxhit në menaxhimin e detyrimeve financiare të përditshme. Për më tepër, një përqindje e konsiderueshme raportuan shkurtime të shpenzimeve ose vonesa në pagesat e faturave, duke i theksuar vështirësitë financiare të përjetuara nga shumë ekonomi familjare. Të dhënat nxjerrin në pah edhe shqetësime për borxhin e akumuluar për shkak të rritjes së koston të jetesës, duke e treguar shqetësimin e individëve për gjendjen e tyre financiare. Rritja e koston të jetesës ka ndikuar ndjeshëm në aftësinë e të anketuarve për t'i shlyer borxhet ekzistuese, duke sugjeruar se shpenzimet e larta të jetesës i kanë tendosur kapacitetet e tyre financiare. **Përgjithësisht, këto të gjetura e tregojnë ndikimin e pafavorshëm të inflacionit tek individët dhe borxhin e shkaktuar nga inflacioni si mekanizëm përballues për t'i luftuar çmimet më të larta.**

### *Ndihma Sociale*

Pyetëtori përfshinte një sërë pyetjesh për ta eksploruar nivelin e varësisë së ekonomive familjare nga programet e ndihmës sociale dhe për t'i kuptuar efektet që ka pasur inflacioni në shumën e ndihmës së pranuar sociale. Së pari, anketa filloi duke i pyetur ekonomitë familjare nëse dikush në shtëpi pranon ndihmë sociale nga Skema e Ndihmës Sociale nga institucionet qendrore të Kosovës. **21.5% e mostrës u përgjigjën se po, dhe prej tyre, 50.6% thanë se e pranuan një shumë midis 100-199 euro, 24.5% më shumë se 200 euro, 14.5% nga 50-99 euro, dhe 10.4% më pak se 50 euro.**

*Figura 34. Përfitimi nga Programi i Ndihmës Sociale dhe shumat për vitin 2023*





Në mesin e ekonomive familjare shqiptare të Kosovës, 22.0% kanë raportuar se ekonomia e tyre familjare aktualisht merr ndihmë sociale. Për ekonomitë familjare serbe të Kosovës, një përqindje më e ulët prej 12.4% kanë përmendur se ekonomitë e tyre familjare marrin ndihmë sociale. Për

dallim, në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, një përqindje dukshëm më e lartë prej 47.9% deklaruan se ekonomia e tyre familjare merr ndihmë sociale.

Grafikët e mëposhtëm i paraqesin të dhënat e ndihmës sociale për sa i përket faktit nëse ekonomitë familjare të etnive të ndryshme marrin ndihmë sociale si dhe shumën e ndihmës së pranuar sociale.

Figura 35. Përfitimi nga Programi i Ndhmës Sociale dhe shumat për vitin 2023, sipas përkatësisë etnike




Më pas, të anketuarve iu parashtruan dy pyetje të tjera nëse këto ekonomi familjare kanë marrë ndihmë sociale në vitin 2021 dhe 2022. Së pari, për vitin 2021, vetëm 21.4% e të anketuarve kanë raportuar se kanë pranuar ndihmë sociale në vitin 2021 dhe 22% për vitin 2022. Megjithatë, nga ata që u përgjigjën se kishin pranuar ndihmë (321 në 2021 dhe 329 në 2022), theksohen të gjeturat e mëposhtme.

Në vitin 2021, afërsisht 10.76% e ekonomive familjare kanë pranuar më pak se 50 euro si ndihmë sociale, ndërsa kjo përqindje është rritur lehtë në 11.64% në vitin 2022. **Kjo sugjeron një trend të**


rritjes marginale në përqindjen e ekonomive familjare që e marrin nivelin më të ulët të ndihmës sociale. Nga ana tjetër, ka pasur një rënie të dukshme të përqindjes së ekonomive familjare që marrin të hyra në shumën prej 50-99 euro, duke rënë nga 22.36% në 2021 në 14.50% në 2022. Megjithatë, kategoria 100-199 euro dëshmoi një rritje të lehtë nga 48.61% në 2021 në 51.14% në 2022, **duke treguar një përqindje më të lartë të ekonomive familjare që bien në këtë grup të të hyrave**. Ndryshimi më i rëndësishëm vërehet në kategorinë "Më shumë se 200 euro", ku përqindja u rrit nga 18.36% në 2021 në 22.72% në 2022. Kjo sugjeron një rritje të dukshme në përqindjen e ekonomive familjare që pranojnë nivele më të larta të ndihmës sociale. Në përgjithësi, këto të gjetura e nxjerrin në pah ndryshimin e shpërndarjes së të hyrave nga ndihma sociale midis ekonomive familjare gjatë dy viteve, me një rënie në shumën e të hyrave mesatare dhe një rritje në kategoritë me të hyra më të ulëta dhe më të larta.

Figura 36. Ndryshimet në Ndhimën Sociale në mes të viteve 2021 dhe 2022



Nga individët që kanë raportuar se kanë marrë pagesa të ndihmës sociale, 97.9% e individëve i kanë raportuar ato çdo muaj, 1% çdo dy muaj, kurse pjesa tjetër një herë në vit. Gjithashtu, në mesin e të anketuarve, 18.0% kanë raportuar se kanë marrë pagesa të ndihmës sociale nga institucionet qendrore, veçanërisht nga departamentet apo divizionet e ministrisë. Në të kundërt, një përqindje më e vogël e të anketuarve, që përbën 3.2%, deklaruan se pagesat e ndihmës sociale i merrnin nga niveli lokal, siç janë departamentet apo drejtoritë komunale. Një përqindje e dukshme e të anketuarve, 76.5%, treguan se pyetja nuk ishte e aplikueshme për ta, duke sugjeruar se ata nuk kanë marrë fare pagesa të ndihmës sociale. Gjithashtu, një përqindje e vogël (2.3%) shprehën pasiguri për burimin e pagesave të ndihmës sociale.

Figura 37. Burimet e Ndhmës Sociale



Rezultatet tregojnë se **ka qenë i kufizuar ndikimi i ndryshimeve në skemën e ndihmës sociale në zgjedhjet e shpenzimeve për ta luftuar inflacionin në Kosovë**. Kjo është kryesisht për shkak se ndihma sociale në Kosovë ka një mbulim të ulët (Banka Botërore, 2010)<sup>28</sup> dhe nuk është përshtatur për inflacionin. Megjithatë, në kuadër të masave të reagimit ndaj pandemisë, institucionet e Kosovës e kanë dyfishuar ndihmën sociale për disa muaj, gjë së cilës mund t'i jenë referuar të anketuarit kur kanë folur për ndryshimet që i kanë parë në ndihmën e tyre sociale.

#### Remitancat


Një nga objektivat e studimit ishte edhe matja e ndikimit të remitancave në luftën kundër inflacionit. Qëllimi ishte të shqyrtohej rëndësia e remitancave në të hyrat e individëve dhe të vlerësohej çdo ndryshim në përqindjen e remitancave gjatë tre viteve të fundit.

Të dhënat sugjerojnë se mbi një e treta e ekonomive familjare në Kosovë pranojnë remitanca (35% në 2021 dhe 2022, dhe 34% në 2022). Ky konstatim sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e ekonomive familjare pranojnë remitanca.

Grafiku i mëposhtëm e përshkruan më tej shumën e remitancave të pranuar nga ekonomitë familjare.

<sup>28</sup> <http://documents1.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/pdf/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options.pdf>

Figura 38. Shuma e remitancave të pranuar nga viti 2021 deri në vitin 2023



Përgjithësisht, këto të gjetura e tregojnë një trend relativisht të qëndrueshëm në remitancat e emigrantëve, me një rritje të lehtë të remitancave me vlerë më të lartë dhe një shumicë konsistente të të anketuarve që nuk e pranojnë asnjë remitancë.


Të gjeturat kyçe në lidhje me sasinë mesatare të remitancave në muaj të pranuar nga ekonomitë familjare nga viti 2021 deri në vitin 2023, të zërthyer sipas rajoneve, janë siç vijon në tabelën e mëposhtme.

Tabela 19. Shuma e remitancave të pranuar nga viti 2021 deri në vitin 2023, sipas përkatësisë etnike

	2021			2022			2023		
	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë, Ashkali, Egjiptas të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë, Ashkali, Egjiptas të Kosovës	Shqiptarë të Kosovës	Serbë të Kosovës	Romë, Ashkali, Egjiptas të Kosovës
<b>Më pak se 50 euro</b>	1.8%	0.0%	9.8%	1.9%	0.0%	8.2%	1.8%	0.0%	3.7%
<b>50-99 euro</b>	3.7%	0.0%	12.4%	3.7%	0.0%	14.9%	3.1%	0.0%	16.8%
<b>100-199 euro</b>	8.8%	0.0%	20.2%	8.5%	0.0%	19.0%	8.2%	0.0%	20.6%
<b>Më shumë se 200 euro</b>	18.3%	0.0%	8.9%	19.0%	0.0%	8.7%	19.6%	0.0%	8.4%
<b>Nuk kemi marrë remitancë</b>	67.4%	94.7%	48.3%	66.8%	95.9%	48.7%	67.5%	96.7%	47.9%
<b>Gjithsej numri i vëzhgimeve</b>	1139	145	140	1149	147	143	1152	148	144

Për më tepër, në mesin e 215 të anketuarve (37% e mostrës që pretenduan se pranonin remitanca) që raportuan se kanë pranuar vazhdimisht remitanca, por niveli i remitancave ka rënë me kalimin e viteve, u pyetën për arsyen që të anketuarit besojnë se qëndron pas kësaj rënieje. Faktorët kyç për ndryshimin janë raportuar të jenë për shkak të rritjes së shpenzimeve të dërguesit, kontabilitetit (32.3%); kushteve ekonomike në vendin e dërguesit (29.4% e të anketuarve); uljes së të hyrave të dërguesit (27.2%); dhe ndryshimeve në kurset e këmbimit (9.4%). Këto të gjetura e nxjerrin në pah perceptimin e individëve se ulja e remitancave të emigrantëve është shkaktuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve të dërguesit, faktorët ekonomikë në vendin e tyre dhe të hyrat në rënie të dërguesit, ku ndryshimet në kursin e këmbimit luajnë një rol dytësor. Është e rëndësishme të theksohet se përderisa pritej që fluksi i remitancave të zvogëlohej për shkak të rritjes së çmimeve në vendet pritëse të diasporës, statistikat zyrtare nga Banka Qendrore e Kosovës tregojnë se remitancat janë rritur gjatë periudhës 2021-2023: janë regjistruar deri në 1.153 miliardë euro në vitin 2021, 1.223 miliardë euro në vitin 2022 dhe, bazuar në flukset hyrëse për periudhën janar-maj, viti 2023 kjo është duke e shfaqur një trend të mëtjeshëm të rritjes.

Figura 39. Arsyet për ndryshimet në remitancat e pranuar gjatë viteve



Të gjeturat në këtë pjesë tregojnë se remitancat mbeten një burim i rëndësishëm financiar në Kosovë, me më shumë se një të tretën e ekonomive familjare që pranojnë remitanca. Sipas statistikave zyrtare, remitancat janë një e treta e vlerës së buxhetit të Kosovës dhe rreth 14-15% e BPV-së. Megjithatë, një pjesë e vogël e pranuesve të remitancave raportuan se remitancat janë ulur për ekonomitë e tyre familjare, kryesisht për shkak të ndryshimeve ekonomike në vendet pritëse të diasporës.




### *Ndikimi i inflacionit në mirëqenien sociale dhe mendore të të anketuarve*

Të kuptuarit e ndikimit të inflacionit në mirëqenien sociale dhe mendore të banorëve është një objektivi vendimtar i studimit, pasi që mirëqenia mendore dhe sociale kontribuon në mënyrë indirekte në cilësinë e përgjithshme të jetës së banorëve dhe produktivitetin e tyre. Ky seksion fokusohet në paraqitjen e të gjeturave që janë përshtatur për ta ngritur të kuptuarit e kësaj teme të veçantë.


Të gjeturat në lidhje me ndikimin e inflacionit në nivelet e stresit, ankthit ose shqetësimit të individëve, zbulojnë se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë përjetuar njëfarë niveli të ndikimit negativ emocional. Në mesin e pjesëmarrësve, gati gjysma e të anketuarve raportuan se kishin përjetuar stres, ankth ose shqetësim për inflacionin (16% raportuan një nivel të lartë stresi, ankthi ose shqetësimi për shkak të inflacionit dhe 31% treguan një nivel të moderuar). Gjysma e të anketuarve, 53%, deklaruan se nuk kanë përjetuar asnjë stres, ankth apo shqetësim lidhur me inflacionin. Ndër ata që kanë përjetuar stres 23.9% e të anketuarve raportuan se inflacioni ka ndikuar në produktivitetin e tyre në punë, dy të tretat deklaruan se inflacioni ka ndikuar në gjumin e tyre, dhe 41.6% e të anketuarve përmendën se inflacioni ka shkaktuar tension në marrëdhëniet e tyre personale.

*Figura 40. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth*




Në përputhje me të gjeturat në këtë raport, të dhënat sugjerojnë se komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës janë më të brishtë ndaj ndryshimeve në kushtet ekonomike. Më shumë se gjysma kanë raportuar të kenë përjetuar stres dhe ankth për shkak të rritjes së çmimeve (krahasuar me një të pestën dhe një të katërtën e komunitetit shqiptar dhe serb të Kosovës, respektivisht).

Figura 41. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth, zberthimi sipas përkatësisë etnike




Sipas gjinisë, femrat duket se janë më të stresuara për inflacionin, kjo mund të lidhet me punësimin e tyre të ulët dhe rrjedhimisht fuqinë/situatën ekonomike.

Figura 42. Ndikimi i inflacionit në stres dhe ankth, sipas gjinisë




Për sa u përket sakrificave personale ose shkurtimeve për shkak të inflacionit, 13% raportuan se kanë bërë sakrifica të rëndësishme dhe 28% kishin bërë disa sakrifica, duke treguar se u është dashur t'i shkurtojnë shpenzimet personale që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre mendore, të tilla si hobi ose kujdesi për veten. Sakrificat e përmendura nga të anketuarit përfshijnë: aktivitete sociale me miqtë ose familjen (83,9%); hobi (11.7%) ushtrime ose aktivitet fizik (18.1%) aktivitete të vetë-kujdesit si masazh, terapi dhe meditim (23.8%).

Figura 43. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve




Zbërthimi sipas përkatësisë etnike tregon se inflacioni ka ndikuar më së shumti tek komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas, pasuar nga komuniteti serb dhe ai shqiptar.

Figura 44. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve, sipas përkatësisë etnike



Kur merret parasysh gjinia, nuk duket të ketë ndonjë ndryshim të dukshëm midis meshkujve dhe femrave. Femrat kishin pak më shumë gjasa të pretendonin se inflacioni ka ndikuar në vendimin e tyre për t'i ulur shpenzimet në krahasim me meshkujt.


Figura 45. Ndikimi i inflacionit në uljen e shpenzimeve, sipas gjinisë



Inflacioni gjithashtu ka ndikuar në përgjithësi në marrëdhëniet personale dhe/ose jetën shoqërore të të anketuarve. 38% janë përgjigjur se inflacioni ka ndikuar në marrëdhëniet e tyre, me 62% që pretendojnë se nuk ka ndikuar.

Nga ata që janë përgjigjur se kanë përjetuar ndikime negative, ndikimi është reflektuar në miqësitë e tyre (70.6%); marrëdhëniet familjare (58,7%); dhe marrëdhëniet profesionale për 15.9%; ndërsa 9.4% deklaruan se ka ndikuar në marrëdhëniet e tyre romantike.


Figura 46. Ndikimi i inflacionit në marrëdhëniet personale ose në jetën shoqërore



Midis pjesëmarrësve, 38% raportuan se kishin përjetuar një shkallë izolimi ose përjashtimi social për shkak të kufizimeve financiare të shkaktuara nga inflacioni (11% përjashtim në shkallë të konsiderueshme dhe 27% deri diku). Megjithatë, shumica e të anketuarve, 62%, raportuan se nuk ndiheshin aspak të izoluar ose të përjashtuar nga shoqëria, duke sugjeruar se kufizimet financiare kanë pasur efekte të kufizuara në angazhimin e tyre social.

Për ata që e kanë ndjerë një lloj izolimi, ngjarjet më të humbura ishin pushimet ose mundësitë e udhëtimit, me plot 86.4% të të anketuarve që treguan se duhej të hiqnin dorë nga përvoja të tilla për shkak të kufizimeve financiare të shkaktuara nga inflacioni. Daljet shoqërore me miqtë ose familjen ishin gjithashtu të prekura, siç raportuan 57.9% e të anketuarve. Për më tepër, 28.0% e pjesëmarrësve nuk shkuan në dasma apo raste të tjera të veçanta, ndërsa 25.7% e të anketuarve nuk shkuan në koncerte apo evente argëtuese.


Figura 47. Përrjashtimi nga eventet shoqërore për shkak të kufizimeve financiare



Në fund, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve raportuan se u është dashur t'u jepnin përparësi shqetësimeve financiare mbi shëndetin e tyre mendor ose mirëqenien sociale për shkak të kufizimeve të ndryshme financiare. Midis pjesëmarrësve, 10% raportuan se u jepnin përparësi shqetësimeve financiare mbi shëndetin mendor në një masë të konsiderueshme, ndërsa 14% treguan se e bënin këtë në një farë mase. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve, që përbën 76.0%, deklaruan se nuk u kishin dhënë përparësi shqetësimeve financiare mbi shëndetin e tyre mendor apo mirëqenien sociale. Këto të gjetura nxjerrin në pah ekuilibrin delikat të individëve në menaxhimin e kufizimeve financiare teksa përpiqen ta ruajnë shëndetin e tyre mendor dhe mirëqenien sociale.


Nga ata që u përgjigjën se duhej t'i jepnin përparësi kufizimeve financiare mbi shëndetin mendor ose mirëqenien sociale (22.5%), shembujt e prioriteteve të tilla ishin të ndryshme. Shembulli më i zakonshëm i raportuar nga pjesëmarrësit ishte shtyrja e një vizite te mjeku ose dentisti për shkak të kufizimeve financiare, duke zënë 75.7% të rasteve. Kjo tregon kompromiset sfiduese me të cilat përballen individët kur bëhet fjalë për prioritetimin e mirëqenies së tyre fizike dhe mendore ndaj kufizimeve financiare. Për më tepër, 25.3% e të anketuarve raportuan se duhej të anulonin ose anashkalonin një seancë terapie në lidhje me shëndetin mendor për shkak të kufizimeve financiare, duke nënvizuar ndikimin e presioneve financiare në qasjen në mbështetjen e nevojshme të shëndetit mendor. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve (23.8%) përmendën punën me orë të gjata ose marrjen e punëve shtesë, gjë që ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre mendor ose në jetën shoqërore. Edhe një herë, përqindjet shtohen në më shumë se 100% për shkak të natyrës së përgjigjeve të shumëfishta të pyetjes.

Figura 48. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit




Kur zërthehen të njëjtat të dhëna sipas përkatësisë etnike, mund të shihet se komunitetet romë, ashkali, egjiptas të Kosovës raportuan se i kishin prioritet më së shumti (45.3%) shqetësimet financiare mbi mirëqenien mendore, pasuar nga serbët e Kosovës (15.3%) dhe komunitetit shqiptar i Kosovës (8.2%).

Figura 49. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit, sipas përkatësisë etnike



Prioriteti i shqetësimeve financiare mbi mirëqenien e tyre ishte pak më i theksuar për femrat (25.3% e femrave krahasuar me 21.9% për meshkujt).

Figura 50. Përparësia e shqetësimeve financiare kundrejt mirëqenies mendore për shkak të inflacionit, sipas gjinisë






Të gjeturat tregojnë se inflacioni ka ndikuar në mirëqenien mendore dhe sociale të individëve, duke çuar në çrregullime në jetën e tyre dhe në aktivitetet e tyre rutinore. Teksa shumica e banorëve nuk përjetuan çrregullime të konsiderueshme, ata që i përjetuan raportuan rritje të stresit, ulje të aktiviteteve sociale dhe sakrifica në aktivitetet e kohës së lirë dhe aktivitetet e lidhura me shëndetin. Aktivitetet normale ditore, të tilla si gjumi dhe produktiviteti në punë, gjithashtu u çrregulluan. Për më tepër, si rezultat i gjithë kësaj u anashkaluan edhe shumë ngjarje të rëndësishme. **Në përgjithësi, inflacioni ka pasur ndikime negative indirekte në cilësinë e jetës së banorëve.**

#### *Veprimi institucional për adresimin e inflacionit*

Një pyetje e fundit u kërkoi të anketuarve të jepnin mendime se çfarë mund të bënte Ekzekutivi i Kosovës ose institucionet e tjera për të ndihmuar që gjërat të jenë më të përballueshme për ekonomitë familjare, me ç'rast mund të përzgjedheshin opsione me përgjigje të shumëfishta. Rritja e pagave përmes përcaktimeve ligjore ishte alternativa më e përzgjedhur, me 88.4%, pasuar nga 69.5% që e përzgjedhën alternativën e vendosjes së tavanëve të çmimeve, ndërsa më shumë programe të ndihmës institucionale për banorët u favorizuan nga 61.2% e të anketuarve. Dhënia e më shumë subvencioneve për bizneset që i rrisin pagat është përzgjedhur nga 42.5%, 24.4%.

Figura 51. Veprimi institucional për trajtimin e inflacionit



## Konkluzionet dhe rekomandimet

Si përfundim, rritja e çmimeve në Kosovë ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e banorëve të Kosovës. Të dhënat e Bankës Botërore zbulojnë ndryshime të larta të çmimeve, me një normë inflacioni të ushqimeve prej 19.4% në dhjetor 2022, krahasuar me 8.8% në janar të të njëjtit vit. Për më tepër, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma vjetore e inflacionit e matur në dhjetor 2022 krahasuar me dhjetor 2021 ishte 12.1%<sup>29</sup>.

Situata është përmirësuar së fundmi siç tregohet nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) i qershorit 2023 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), i cili është 2.8% më i lartë krahasuar me qershorin 2022. Megjithatë, norma e inflacionit midis muajit maj dhe qershor 2023 mbetet në nivelin 0%<sup>30</sup>.

Këto statistika e theksojnë urgjencën për të kuptuar se si ka ndikuar inflacioni në mirëqenien ekonomike të individëve dhe pozicionin e tyre në varfëri. Për ta adresuar këtë çështje, është iniciuar një raport i Analizës së Pulsit Publik për ta vlerësuar ndikimin e inflacionit në popullin e Kosovës. Duke i përdorur anketat e ekonomive familjare, kjo analizë synoi t'u përgjigjej pyetjeve kyçe të mëposhtme: shkallën e zgjedhjeve ekonomike të ndikuara nga inflacioni, ndryshimin e shkallës së varfërisë për shkak të ndryshimeve të çmimeve, ndikimi i inflacionit në borxhin e ekonomive familjare, rolin e të hyrave nga diaspora dhe programeve të mbrojtjes sociale në formësimin dhe përballimin e zgjedhjeve të shpenzimeve dhe niveleve të të hyrave; dhe ndikimi i inflacionit në cilësinë e përgjithshme të jetës në nivel të ekonomive familjare.

Bazuar në të gjeturat kyçe, janë paraqitur rekomandimet e mëposhtme.

Së pari, duhet të zbatohen reformat e tregut të punës dhe mbështetja ekonomike, duke përfshirë inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve ndërmarrëse për ta nxitur vetëpunësimin dhe krijimin e vendeve të punës.

## Politikat për krijim të vendeve të punës

Duhet të zhvillohen politika për të tërhequr investime të huaja dhe për të stimuluar rritjen në industrinë me intensitet të punës dhe ato me potencial për rritje si prodhimi, ndërtimtaria, tregtia me pakicë dhe mikpritja. Mbështetjes për bizneset në pronësi të femrave duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

---

<sup>29</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit. Dhjetor 2022. Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/harmonized-index-of-consumer-prices-hicp-december-2022>

<sup>30</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit. qershor 2023 Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/harmonized-index-of-consumer-prices-hicp-june-2023>

## **Përshtatja i ndihmës sociale dhe rritja e mbulimit**

Siç raportohet në këtë raport, sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, skema e ndihmës sociale karakterizohet me mbulim të ulët dhe madhësia e saj bazohet në një shportë të vjetëruar konsumi. Kritika ka edhe për kriteret për ta hequr një ekonomi familjare nga Kategoria 2 e Ndihmës Sociale, dhe këto kritere duhet të rishikohen. Reforma në vazhdim e skemave të ndihmës sociale duhet t'i marrë parasysh këto aspekte. Për më tepër, kriteret sipas të cilave një përfitues i ndihmës sociale dhe veteranët e konfliktit të vitit 1999 hiqen automatikisht kur marrin të hyra të tatueshme, pasi që po i shtyn përfituesit të punojnë si punëtorë informalë. Punëtorët informalë janë më të brishtë në kohë krizash, prandaj ky kriter i ngurtë duhet të rishikohet (për shembull mund të vendoset një tavan për të hyrat shtesë nga puna).

## **Rritja e pagës minimale**

Që nga vendosja e saj në vitin 2011, paga minimale nuk është rritur në Kosovë. Propozimi i fundit për 250 euro nuk është miratuar ende nga Ekzekutivi i Kosovës dhe punëdhënësit mund t'i paguajnë punëtorët me 170 euro.

## **Benefitet për fëmijë**

Institucionet e Kosovës kanë filluar zbatimin e benefiteve për fëmijë, të cilat edhe pse janë 10 euro në muaj për fëmijë janë një politikë e rëndësishme. Në të ardhmen, në përputhje me hapësirën fiskale, benefiti duhet të rritet.

## **Politikat e tregut aktiv të punës**

Ndihma sociale është një mekanizëm i rëndësishëm për t'i mbështetur ata që kanë më shumë nevojë. Duke qenë se ndryshimet në politikat publike si ndihma sociale nuk bëhen shpesh, përfituesit e një mbështetjeje të tillë janë të parët që goditen me rritjen e çmimeve. Prandaj, institucionet duhet ta mbështesin aktivizimin e përfituesve të ndihmës sociale për ta adresuar varësinë e tyre nga skemat sociale. Pjesëmarrja në masat e tregut aktiv të punës të ofruara nga Agjencia e Punësimit dhe masat e tjera të ofruara përmes ministrive, duhet t'i kenë si prioritet përfituesit e ndihmës sociale. Programet duhet të përshtaten për t'i adresuar nevojat dhe kërkesat e femrave, komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, personave me nevoja të veçanta dhe nënave vetushqyese.

## **Parashikimi për t' parandaluar ndryshimet e çmimeve**

Gjatë rritjes së çmimeve, kompanitë ka gjasa t'i rrisin çmimet më shumë seç duhet për ta rritur fitimin e tyre. Institucionet dhe organet inspektuese duhet t'i rrisin kapacitetet e tyre inspektuese dhe në baza të rregullta t'i ndjekin ndryshimet e çmimeve.

Në fund, duhet të ndërmerren fushata dhe iniciativa mbështetëse. Duhet të zhvillohen fushata vetëdijesimi për t'i edukuar ekonomitë familjare për buxhetimin, menaxhimin financiar dhe strategjitë e përbalimit gjatë periudhave të inflacionit. Të krijohen platforma për reagime dhe

shqetësime të banorëve për të siguruar që këndvështrimet e tyre të merren parasysh në proceset e politikëbërjes.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të interesit të sektorit privat, është vendimtar për t'i mbështetur kolektivisht individët më në nevojë.

## Referencat

1. BERZH. “Diagnostikimi i Vendit për Kosovën: Sfidat dhe mundësitë për investime private” (2022).
2. Banka Qendrore Evropiane. Ndikimi i rritjes së fundit të inflacionit nëpër ekonomi familjare. (2023). Në dispozicion në: [https://www.ecb.EURpa.eu/pub/economic-bulletin/articles/2023/html/ecb.ebart202303\\_02~037515ed7d.en.html](https://www.ecb.EURpa.eu/pub/economic-bulletin/articles/2023/html/ecb.ebart202303_02~037515ed7d.en.html)
3. GIZ. Varfëria energjetike në Kosovë. (2021). Në dispozicion në: <https://www.giz.de/en/downloads/giz2023-en-factsheet-energy-poverty.pdf>
4. Harvard Business Review. Çka e shkakton inflacionin? (2022). Në dispozicion në: <https://hbr.org/2022/12/what-causes-inflation>
5. Inflacioni, çmimet e konsumit (% vjetore) – Kosovë. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/indicator/FP.CPI.TOTL.ZG?locations=XK>
6. Organizata Ndërkombëtare e Punës. Raporti Global për Pagat - 2022-2023: Ndikimi i inflacionit dhe COVID-19 në paga dhe fuqi blerëse. Në dispozicion në: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed\\_protect/---protrav/---travail/documents/publication/wcms\\_862569.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---travail/documents/publication/wcms_862569.pdf)
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore TM2 2022. Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/media/6953/labour-force-survey-q2-2021.pdf>
8. Anketa për Pjesëmarrjen në Fuqinë Punëtore. TM1 2022. Në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/media/7528/labour-force-survey-q1-2022.pdf>
9. Penn Wharton. Ndikimi i inflacionit sipas të hyrave të ekonomive familjare. (2021). Në dispozicion në: <https://budgetmodel.wharton.upenn.edu/issues/2021/12/15/consumption-under-inflation-costs>
10. Prishtina Insight. Kosova mbyll vitin 2022 me inflacion rekord (2022). Në dispozicion në: [https://prishtinainsight.com/kosovo-ends-2022-with-record-inflation/#:~:text=%E2%80%9CThis%20is%20mainly%20explained%20by,\(19.5%25\)%E2%80%9D%20KAS%20said.](https://prishtinainsight.com/kosovo-ends-2022-with-record-inflation/#:~:text=%E2%80%9CThis%20is%20mainly%20explained%20by,(19.5%25)%E2%80%9D%20KAS%20said.)
11. Rama et al. Vështrim Ligjor i Ndërtimit të Ndërtesave të Reja dhe Banimet në Kosovë. Në dispozicion në: <https://ceelegalmatters.com/briefings/16808-legal-overview-of-construction-of-new-buildings-and-housing-in-kosovo>
12. Përditësimi i Bankës Botërore për Sigurinë Ushqimore. (2023). Në dispozicion në: <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/40ebbf38f5a6b68bfc11e5273e1405d4-0090012022/related/Food-Security-Update-LXXVII-January-26-2023.pdf>
13. Banka Botërore në Kosovë. Përmbledhje. Në dispozicion në: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>
14. Banka Botërore BPV për kokë (US \$ aktuale) – anëtarët e OECD-së. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/kosovo>
15. Banka Botërore Të dhëna makroekonomike për Kosovën. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/kosovo>
16. Banka Botërore Vendet me të hyra të mesme të larta. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/country/XT>

17. Libri Botëror i Fakteve. Kosova: Përmbledhja e vendit. Në dispozicion në: <https://www.cia.gov/the-world-factbook/countries/kosovo/summaries/>
18. Ekonomia e tregtimit. Kosova- Pranimi i remitançave të punëtorëve dhe kompensimi i punonjësve (% e BPV). Në dispozicion në: [https://tradingeconomics.com/kosovo/personal-remittances-received-percent-of-gdp-wb-data.html#:~:text=Personal%20remittances%2C%20received%20\(%25%20of,compiled%20from%20officially%20recognized%20sources.](https://tradingeconomics.com/kosovo/personal-remittances-received-percent-of-gdp-wb-data.html#:~:text=Personal%20remittances%2C%20received%20(%25%20of,compiled%20from%20officially%20recognized%20sources.)
19. Ekonomia e tregtimit: Shkalla e papunësisë në Kosovë. Në dispozicion në: <https://tradingeconomics.com/kosovo/unemployment-rate>
20. Ekonomia e tregtimit. Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) në Kosovë. Në dispozicion në: <https://tradingeconomics.com/kosovo/consumer-price-index-cpi>
21. UNDP. Vlerësimi i ndikimit të krizës së Ukrainës në Kosovë: Një ushtrim i Parashikimit Strategjik duke përfshirë projeksione të bazuara në skenarë (2022). Në dispozicion në: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-03/Assessing%20the%20Impact%20of%20the%20Ukraine%20crisis%20on%20Kosovo%20-%20An%20Exercise%20in%20Strategic%20Foresight%20Including%20Scenario-Based%20Projections.pdf>
22. Banka Botërore, 2019, Studimi i Skemës së Ndihmës Sociale në Kosovë: Vlerësimi dhe Opsionet e Reformës (anglisht). Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore Në dispozicion në <http://documents.worldbank.org/curated/en/994991557470271998/Kosovo-Social-Assistance-Scheme-Study-Assessment-and-Reform-Options>